



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
SEKTORI I AUDITIT TË BRENDSHËM

Nr. 978 Prot.

Ersekë, më 26.01.2025

Lënda: Raporti Përfundimtar i Auditimit të Përputhshmërisë së ushtruar në Njësitë Administrative

Kryetarit, Z. Erion Isai;
Njësisë Administrative Qendër-Leskovik;
Njësisë Administrative Qendër-Ersekë;
Njësisë Administrative Mollas-Çlirim;
Njësisë Administrative Barmash-Novoselë.

Mbështetur në gjurmën “a” të nenit 6, pikën “1” të nenit 9 si dhe gjurmën “a” të nenit 14 të Ligjit Nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” (i ndryshuar), Manualin Për Auditimin e Brendshëm të Ministrisë së Financave, Planin Vjetor të miratuar nga Titullari i Institucionit me Nr. 3044/1 Prot., datë 24.06.2024 (i rishikuar) për vitin 2024, si dhe në Autorizimin Për Fillimin dhe Përgatitjen e Angazhimit për Auditim Nr.5309 Prot., datë 11.11.2024 dhe Programit të miratuar të Angazhimit për Auditim Nr.5464 Prot., datë 20.11.2024, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka hartuar Raportin Përfundimtar të Auditimit së bashku me anekset përkatëse mbi Angazhim-Auditimin e Përputhshmërisë së ushtruar në Njësinë Administrative Qendër-Leskovik, Njësinë Administrative Qendër-Ersekë, Njësinë Administrative Mollas-Çlirim, Njësinë Administrative Barmash-Novoselë.

Afati i përgatitjes dhe dorëzimit të Planit të Veprimit për ndjekjen e Rekomandimeve, është jo më vonë se 30 ditë nga marrja e Raportit Përfundimtar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PËR NJËSINË E AUDITIT TË BRENDSHËM
Përgjegjës i Komanduar
Laura Skënderas



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
SEKTORI I AUDITIT TË BRENDSHËM

Nr. 976 Prot.

Ersekë, më 26.01.2025

RAPORT PËRFUNDIMTAR

AUDITIM PËRPUTHSHMËRIE

NË NJËSITË ADMINISTRATIVE

PËRMBAJTJA E LËNDËS

I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	2
II.	HYRJE.....	5
III.	METODA E AUDITIMIT	7
IV.	GJETJET, KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET PËR ÇDO SISTEM .	8
V.	ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA MË PARË	74
	ANEKSI Nr.1	76
	ANEKSI Nr.2	80

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Nga struktura organizative e Bashkisë Kolonjë e miratuar për vitin 2024, rezulton se nga organizimi dhe ndarja territoriale ka pasur gjatë vitit 2024, 4 Njësi Administrative, përkatësisht:
 - a) Njësia Administrative Mollas-Çlirim;
 - b) Njësia Administrative Barmash-Novoselë;
 - c) Njësia Administrative Qendër-Leskovik;
 - d) Njësia Administrative Qendër-Ersekë.
2. Në bazë dhe për zbatim të nenit 5, nenit 6 pika “b” ii), v) dhe vi), si dhe pikës 2 të Nenit 9 të Ligjit Nr. 114/2015, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” (*i ndryshuar*), “Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, miratuar me Urdhërin Nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave, Planit Vjetor të miratuar nga Titullari i Institucionit me Nr. 3044/1 Prot., datë 24.06.2024 (*i rishikuar*) për vitin 2024 si dhe Urdhërit të Shërbimit Nr. 5309 Prot., datë 11.11.2024 të Përgjegjësit të Auditit të Brendshëm, Njësia e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Kolonjë, ushtroi auditimin në 4 Njësitë Administrative:
 - a. Njësia Administrative Mollas-Çlirim;
 - b. Njësia Administrative Barmash-Novoselë;
 - c. Njësia Administrative Qendër-Leskovik;
 - d. Njësia Administrative Qendër-Ersekë.
3. Objekti i Auditimit: Vlerësimi i përputhshmërisë ligjore të veprimeve të kryera në përmbushje të detyrave të Njësive Administrative, vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, identifikimin e risqeve të mundshme, dhënien e rekomandimeve për minimizimin e risqeve dhe përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm. Për identifikimin e sistemeve, grupi i auditimit u bazua në intervistat e kryera me Administratorët dhe Drejtues të tjerë Menaxherialë të Bashkisë Kolonjë, në dispozitat ligjore mbi organizimin dhe funksionimin e Njësive Administrative, në strukturën organizative dhe dokumentacionin që disponojnë Njësitë.
4. Qëllimi i Auditimit: Informimi i menaxhimit mbi punën e kryer nga Njësitë Administrative, raportimi i gjetjeve dhe konkluzioneve, dhënia e opinioneve për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, dhënia e rekomandimeve për të ndihmuar Njësitë Administrative në përmirësimin e veprimtarisë së tyre në arritjen e objektivave.
5. Periudha e Auditimit: 01.01.2024-11.11.2024
6. Përmbledhje e gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve kryesore:

Megjithë punën e mirë të kryer nga disa prej punonjësve dhe administratorët e Njësive Administrative, misioni i angazhimit të auditimit ka konstatuar disa parregullësi në drejtim të:
7. **A. Planifikimi dhe Menaxhimi i Burimeve**

-Ka pasur mungesë dokumentacioni në dosjet e personelit të Njësive Administrative.

-Nuk janë kryer vlerësimet e punës.

-Mungojnë parashikimet në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Kolonjë mbi funksionet, detyrat dhe kompetencat e Administratorëve, por parashikohet vetëm numri i Njësive Administrative dhe emrat e tyre.

-Nuk janë kryer trajnime specifike për punonjësit.

-Mungojnë dokumentat shoqërues për procedurat e pranimit në shërbimin civil apo mbi punonjësit e Gjendjes Civile (dhe përgjegjësat).

-Mungojnë Kontratat e Punës për Administratorët.

-Nuk është ngritur Komision për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve publike të konstatuara si të papërdorshme nga Komisionet e Inventarizimit.

8. **B. Krijimi dhe Implementimi i Sistemeve**

-Dokumentacioni nuk është mbajtur i rregullt që të reflektojë në mënyrë të saktë rastet e bashkëpunimit mes Njësive Administrative, mes tyre dhe Bashkisë apo institucioneve të tjera dhe në disa Njësi ky dokumentacion mungon totalisht.

-Proceset e punës dhe ofrimit të shërbimeve nuk janë dixhitalizuar për shkak të mungesës së infrastrukturës.

9. **C. Përputhshmëria me Rregulloret dhe Procedurat**

-Nuk janë përmbushur, qoftë në total, qoftë pjesërisht, detyrat dhe funksionet e Njësive Administrative sipas parashikimeve të bëra nga nenin 66 të Ligjit Nr. 114/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” (*i ndryshuar*).

-Për vënien në dispozicion të Njesisë së Auditit të Brendshëm të informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar, një pjesë e Njësive Administrative e kanë dorëzuar me shkresë përcjellëse dhe një pjesë, ose nuk ka dërguar informacionin me shkresë përcjellëse, ose nuk kanë dërguar informacion dhe dokumentacion.

-Mungon Regjistri i Korrespondencës (Protokollit) në disa Njësi Administrative.

-Për Njësitë që kanë Regjistër Korrespondence (Protokollit), nuk e kanë mbajtur sipas parashikimeve ligjore.

-Dokumentacionit shpesh i mungon data e protokollimit, numri ose vula dhe shpesh herë këto janë vendosur me mjete elektronike, në kundërshtim me kërkesat ligjore.

-Nuk janë respektuar kërkesat ligjore mbi formatin e dokumentave administrativë.

-Mungon rakordimi midis numrit të protokollit dhe datës së dokumentit në disa dokumenta.

-Ka mungesë dokumentacioni në disa fusha (kontratat me fermerët, gjendja civile, shërbimet publike etj.).

-Nuk është raportuar periodikisht mbi veprimtarinë e Njësive Administrative.

-Nuk janë marrë masat për adresimin e problematikave dhe boshllëqeve që janë hasur në zbatimin e detyrave ligjore.

10. **D. Shërbimet dhe Ndikimi mbi Qytetarët**

-Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se ka mungesë të kërkesave të qytetarëve apo kryepleqve të zonës për plotësimin e nevojave apo shërbimeve bazike.

-Nuk dokumentohen kërkesat e qytetarëve në një pjesë të Njësive Administrative.

11. **E. Risku dhe Sfida për Funkzionimin**

-Nuk është hartuar Regjistri i Riskut për vlerësimin e risqeve në Njësiti Administrative.

-Nuk janë adresuar sfidat e hasura në përmbushjen e detyrave.

-Nga auditimi i kaluar rezulton se nuk është paraqitur asnjë Plan Veprimi nga Njësiti Administrative dhe për rrjedhojë nuk ka dokumentacion që të provojë se janë marrë masat e parashikuara nga ligji për ndjekjen e rekomandimeve.

12. **F. Gjendja Civile**

-Nuk është dorëzuar dokumentacion nga Njësiti Administrative pranë të cilave funksionon shërbimi i gjendjes civile që të reflektojë përmbushjen e detyrave të tyre funksionale.

13. **G. Mbledhja e Taksave dhe Tarifave Vendore**

-Nga Njësia Administrative Qendër-Leskovik, pranë së cilës funksionon sistemi i taksave dhe tarifave vendore nuk është dorëzuar asnjë dokumentacion relevant, pavarësisht kërkesave për dorëzimin e plotë dhe të detajuar të dokumentacionit.

14. **I. Financa**

-Nga Njësia Administrative Qendër-Leskovik pranë së cilës funksionon sistemi i financës nuk është dorëzuar asnjë dokumentacion relevant, pavarësisht kërkesave për dorëzimin e plotë dhe të detajuar të dokumentacionit.

15. **J. Shërbimet Publike**

-Mungon dokumentacioni në një pjesë të Njësive Administrative mbi kërkesat për të përfituar nga shërbimet publike sipas nevojave të qytetarëve.

16. Për të gjitha rastet e konstatuara më sipër, grupi i auditimit ka dhënë rekomandimet përkatëse, të cilat janë pasqyruar edhe në **Ankesin Nr. 1**.

17. Opinion mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm

Sistemet e kontrollit të brendshëm janë vlerësuar nga niveli i lartë i menaxhimit, në tërësinë e tyre kanë funksionuar pjesërisht dhe kanë qenë pjesërisht efektive, pasi ka pasur shmangie nga marrja e masave për përmirësimin e tyre, nuk është bërë asnjë vlerësim rrisht, mungojnë po aq masat korrigjuese të ndërmarra nga auditimi i kaluar dhe dokumentacioni bashkëshoqërues i tyre, gjë që ka ndikuar në funksionimin jo të duhur të sistemeve dhe mosrealizimin efektiv të objektivave në tërësi.

II. HYRJE

18. Në 4 Njësitë Administrative u realizua auditim përputhshmërie që përfshiu sistemin e gjendjes civile, taksave dhe tarifave vendore, financës, shërbimeve publike, planifikimit dhe menaxhimit të burimeve, krijimit dhe implementimit të sistemeve, përputhshmërisë ligjore dhe procedurale, ofrimit të shërbimeve dhe ndikimit të tyre mbi qytetarët, menaxhimit të riskut dhe marrjes së masave për të kaluar sfidat në sistemet e kontrollit të brendshëm dhe zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm.
19. Auditimi u krye bazuar në dispozitat ligjore të mëposhtme:
- Ligjit Nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"(i ndryshuar);
 - Ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" (i ndryshuar);
 - Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar);
 - Ligji Nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil" (i ndryshuar);
 - Ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar);
 - Ligji Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" (i ndryshuar);
 - Ligji Nr. 1954/2003 "Për Arkivat" (i ndryshuar);
 - Ligji Nr. 7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar);
 - Ligji Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar);
 - Manuali Për Auditimin e Brendshëm të Ministrisë së Financave;
 - Manual Trajnimi Për Punonjësit e Zyrës së Arkivit dhe Protokollit të Njësive të Qeverisjes Vendore;
 - Manual Praktik Mbi Njësitë e Burimeve Njerëzore në institucionet e Administratës Publike;
 - VKM Nr. 4 datë 19.06.2017 për miratimin e "Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë";
 - Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" (i ndryshuar) i Ministrisë së Financave;
 - Vendime relevante të Këshillit Bashkiak Kolonjë etj.
20. Auditimi u krye në zbatim të Planit Vjetor të Auditimit të miratuar nga Titullari i Institucionit me Nr. 3044/1 Prot., datë 24.06.2024 (i rishikuar) si dhe Programit të Angazhim Auditimit Nr. 5464 Prot., datë 20.11.2024.
21. Për fillimin e misionit, grupi i auditimit zhvilloi takimin prezantues në datë 25.11.2024 në ambientet e Bashkisë Kolonjë. Në takim u prezantua qëllimi dhe tematika e auditimit, ku palët ranë dakord për fillimin e misionit të auditimit, sipas Programit të Auditimit të miratuar dhe Axhendës paraprake.
22. Misioni i auditimit u krye nga grupi i auditimit i përbërë nga:

Znj. Laura Skënderas - audituese, njëkohësisht përgjegjëse e grupit;
Z. Arnold Fetallari – auditues.

23. Afati i auditimit: 26.11.2024 deri më 10.02.2025.
24. Më datë 10.02.2025 gjatë takimit me Titullarin e Institucionit, u vu në djeni mbi ecurinë e angazhimit, problematikat e hasura, gjetjet dhe rekomandimet e lëna nga grupi i auditimit.

III. METODA E AUDITIMIT

25. Në misionin e auditimit janë përdorur metoda dhe teknika si:
1. **Rishikimi i dokumentacionit** përmes verifikimit nëse Njësitë Administrative i zbatojnë ligjet, rregulloret dhe udhëzimet përkatëse, shqyrtimi i regjistrave dhe dosjeve duke kontrolluar kontratat, faturat, raportet financiare dhe dokumentat zyrtare për përputhshmëri.
 2. **Intervistat me punonjësit** për të marrë informacion mbi proceset dhe praktikat e ndjekura.
 3. **Vëzhgimi në terren** përmes inspektimeve fizike duke kontrolluar objektet dhe zyrat për të siguruar që ato përdoren në përputhshmëri me qëllimet e deklaruara.
 4. **Krahasimi (Benchmarking)** me standardet ligjore duke verifikuar përputhjen e aktiviteteve me standardet kombëtare ose ndërkombëtare.
 5. **Analiza e të dhënave** për të kontrolluar performancën e Njësive Administrative në periudha të ndryshme për të identifikuar devijime të mundshme.
 6. **Testimi i mostrave (Sampling)** duke zgjedhur dokumenta, transaksione apo vendime dhe akte administrative të tjera për të vlerësuar përputhshmërinë ligjore.
 7. **Metoda e ndjekjes (Follow-up)** përmes kontrollit të masave korigjuese të marra pas auditimeve të mëparshme për të siguruar se janë adresuar problemet e identifikuara.
 8. **Shqyrtimi i ankesave dhe feedback-ut** përmes përdorimit të raportimeve ose ankesave nga qytetarët ose palët e tjera të interesuara për të identifikuar problematikat (nëse ka).
26. U plotësuan pyetësorët për mjedsin e kontrollit të brendshëm, funksionimin organizativ të Njësive Administrative etj. U vlerësua hartimi dhe zbatimi i Plan-Veprimit mbi rekomandimet e dhëna në auditimin e mëparshëm.
27. Grupi i auditimit gjykoi se ky dokumentacion është i mjaftueshëm për të mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve, përveç rastit të Njesisë Administrative Qendër-Ersekë, Administratori i së cilës në shkelje të hapur të urdhërave të Titullarit të Institucionit, nuk dorëzoi asnjë dokumentacion.

IV. GJETJET, KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET PËR ÇDO SISTEM

Sipas strukturës së miratuar për vitin 2024, Njësitë Administrative kanë qenë 4 dhe kanë funksionuar në zbatimin të Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) si dhe akteve të tjera në bazë dhe për zbatim të tij dhe Rregullores së Brendshme të Bashkisë Kolonjë.

28. 4.1 SISTEMI I PLANIFIKIMIT DHE MENAXHIMIT TË BURIMEVE

1. Titulli i Gjetjes: Mungon kopja e njehsuar me origjinalin e Diplomës së Nivelit të dytë të Studimeve, Master Profesional në Marketing e Administratorit.

Nr. i Gjetjes 1	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE BARMASH-NOVOSELË
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> Njësia Administrative Bramash-Novoselë; Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> Ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); Manual Praktik Mbi Njësitë e Burimeve Njerëzore në institucionet e Administratës Publike.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Në Jetëshkrimi i Administratorit ka të deklaruar Diplomë të Nivelit të dytë të Studimeve, Master Profesional në Marketing, por ky dokument mungon në dosjen e personelit.</p> <p>Kriteri: Manual Praktik Mbi Njësitë e Burimeve Njerëzore në institucionet e Administratës Publike.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Nuk justifikohet me dokumentacion të plotë për efekt provues/vërtetues se Administratori ka përfunduar nivelin e dytë të studimeve Master Profesional në Marketing.</p> <p>Shkaku: Neglizhencë dhe mungesë e kontrollit nga Njësia Përgjegjëse.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i mesëm.
Konkluzioni	Neglizhencë në mbajtjen e dokumentacionit në dosjen e personelit dhe plotësimin të kërkesave ligjore.
Rekomandimi	Të plotësohet dosja me Vërtetim Njësimit me Origjinalin të Diplomës së Nivelit të dytë të Studimeve, Master Profesional në Marketing.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë.
Statusi i rekomandimit	Është paraqitur Observacion.

2. Titulli i Gjetjes: Nuk është bërë asnjë vlerësim i punës së kryer nga ana e administratorit për vitin 2024.

Nr. i Gjetjes 2	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE BARMASH-NOVOSELË
Njësitë/ subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Njësia Administrative Bramash-Novoselë; • Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (<i>i ndryshuar</i>); • Manual Praktik Mbi Njësitë e Burimeve Njerëzore në institucionet e Administratës Publike.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Për vitin 2024, rezulton se nuk është bërë asnjë vlerësim i punës së kryer nga ana e administratorit, duke shkelur parashikimet e bëra nga pika “1” të nenit 35 të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës” (<i>i ndryshuar</i>).</p> <p>Kriteri: Ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (<i>i ndryshuar</i>); Manual Praktik Mbi Njësitë e Burimeve Njerëzore në institucionet e Administratës Publike.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Nuk justifikohet me dokumentacion të plotë për efekt provues/vërtetues se Administratori ka vlerësime pozitive në kryerjen e detyrave funksionale.</p> <p>Shkaku: Neglizhencë dhe mungesë e kontrollit nga Njësia Përgjegjëse.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i mesëm.
Konkluzioni	Neglizhencë në mbajtjen e dokumentacionit në dosjen e personelit dhe plotësimin të kërkesave ligjore për vlerësimin e punonjësve.
Rekomandimi	Të merren masat për kryerjen e vlerësimit të punës sipas parashikimeve ligjore.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë.
Statusi i rekomandimit	Është paraqitur Observacion.

3. Titulli i Gjetjes: Në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Kolonjë mungon një seksion i posaçëm për të rregulluar detyrat dhe funksionet e Administratorëve.

Nr. i Gjetjes 3	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE BARMASH-NOVOSELË
Njësitë/ subjektet e interesuara nga	<ul style="list-style-type: none"> • Njësia Administrative Bramash-Novoselë; • Bashkia Kolonjë.

gjetja	
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar).
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Kolonjë miratuar me Vendimin Nr. 157, datë 15.12.2023 nga Këshilli Bashkiak “Mbi miratimin e Rregullores së Brendshme për organizimin, funksionimin, detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e administratës në Bashkinë Kolonjë”, e cila ka qenë në fuqi gjatë vitit 2024, në Kreun VII Njësitë Administrative dhe Organizative të Bashkisë Kolonjë, neni 27 parashikon vetëm ndarjen e Njësive Administrative, pa bërë një parashikim të qartë të funksioneve të tyre, detyrave dhe kompetencave të Administratorëve.</p> <p>Kriteri: Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar).</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mungon një kornizë të qartë për funksionet, detyrat dhe kompetencat e Administratorëve të këtyre Njësive, duke sjellë shmangie nga kryerja e detyrave dhe mospërbushjen e detyrimeve ligjore.</p> <p>Shkaku: Neglizhencë dhe mungesë e kontrollit nga Njësia Përgjegjëse.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i lartë.
Konkluzioni	Rregullorja e Brendshme e Bashkisë Kolonjë, në formën aktuale, ka një mangësi të rëndësishme pasi nuk parashikon funksionet, detyrat dhe kompetencat e administratorëve të Njësive Administrative. Kjo mund të çojë në paqartësi dhe vështirësi në menaxhimin e administratës lokale, duke e bërë më të vështirë për administratorët të kuptojnë përgjegjësitë e tyre dhe të realizojnë detyrat në mënyrë efikase. Për të përmirësuar funksionimin e administratës dhe për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie, është e nevojshme që rregullorja të rishikohet dhe të përfshijë një përcaktim të qartë dhe të detajuar për rolet dhe përgjegjësitë e administratorëve në çdo njësitë administrative.
Rekomandimi	Të rishikohet Rregullorja e Brendshme dhe të përcaktohen qartë detyrat dhe kompetencat e Njësive Administrative dhe Administratorëve si dhe linjat e raportimit.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Brenda 3 mujorit të parë 2025.
Statusi i rekomandimit	Është paraqitur Observacion.

4. Titulli i Gjetjes: Nuk janë kryer trajnime nga punonjësi i Njesisë.

Nr. i Gjetjes 4	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE BARMASH-NOVOSELË

Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> Njësia Administrative Bramash-Novoselë; Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> Ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (<i>i ndryshuar</i>).
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Gjatë vitit 2024, nuk janë kryer trajnime nga punonjësi i Njesisë. Nga vlerësimi i dosjes së personelit, vërehet nevoja për trajnime të vazhdueshme në fushën e legjislacionit administrativ.</p> <p>Kriteri: Ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (<i>i ndryshuar</i>).</p> <p>Ndikimi/Efekti: Ka krijuar një boshllëk në përgatitjen dhe aftësitë e stafit për të përballuar ndryshimet dhe kërkesat e legjislacionit administrativ, ka ndikuar negativisht në efektivitetin dhe saktësinë e punës së administratës, duke rritur mundësinë e gabimeve ligjore dhe administratve që mund të çojnë në vonesa, probleme me implementimin e ligjeve dhe rregulloreve, dhe mungesë të transparencës.</p> <p>Shkaku: Neglizhencë dhe mungesë e kontrollit nga Njësia Përgjegjëse.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i mesëm.
Konkluzioni	Mungesa e trajnimeve gjatë vitit 2024 për punonjësit e Njesisë Administrative ka pasur një ndikim negativ në përgatitjen dhe aftësitë e stafit për të menaxhuar legjislacionin administrativ.
Rekomandimi	Të merren masat për t’u zhvilluar trajnime nga ana e Administratorit në fushën e legjislacionit administrativ.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Është paraqitur Observacion.

5. Titulli i Gjetjes: Krijimi i vakancës nga emërimi i Administratorit në pozicion tjetër.

Nr. i Gjetjes 5	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE BARMASH-NOVOSELË
Njësitë/ subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> Njësia Administrative Bramash-Novoselë; Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> Ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (<i>i ndryshuar</i>); Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (<i>i ndryshuar</i>).

Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Gjatë vitit 2024 Njësia ka funksionuar me një punonjës me detyrë Administrator, i cili më pas është emëruar në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Pyjeve, Parqeve dhe Rekeracionit. Nga auditimi i fundit është vënë re reduktimi i numrit të punonjësve nga 2 në 1. Nuk ka asnjë vakancë për vitin 2024.</p> <p>Kriteri: Ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar).</p> <p>Ndikimi/Efekti: Është krijuar një ngarkesë të madhe për këtë individ, duke i vendosur atij një përgjegjësi të shtuar. Ky reduktim i numrit të punonjësve nga 2 në 1 mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara nga Njësia Administrative, pasi një punonjës mund të ketë vështirësi në menaxhimin e gjithë detyrave që mbulonin dy persona.</p> <p>Shkaku: Ristrukturimi dhe riorganizmi brenda institucionit.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i lartë.
Konkluzioni	Konkluzioni është se reduktimi i numrit të punonjësve nga 2 në 1 dhe mungesa e vakancave për vitin 2024 ka krijuar një ngarkesë të madhe për punonjësin e mbetur, duke e vështirësuar menaxhimin e detyrave dhe përgjegjësi të Njesisë Administrative. Kjo situatë mund të ndikojë negativisht në cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve të ofruara, duke krijuar mundësi për vonesa dhe gabime në proceset administrative. Për të përmirësuar funksionimin dhe për të siguruar një administratë më të efektshme, është e nevojshme që Bashkia Kolonjë të rishikojë strukturën e stafit dhe të marrë masa për të mbushur vakancat e mundshme, duke siguruar një balancë më të mirë mes burimeve njerëzore dhe ngarkesës së punës.
Rekomandimi	Të merren masat për emërimin e një administratori tjetër në vakancën e krijuar.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë.
Statusi i rekomandimit	Është paraqitur Observacion.

6. Titulli i Gjetjes: Nuk është ngritur Komisioni për Nxjerrjen Jashtë Përdorimit të Aktiveve të konstatuara si të tilla nga Komisioni i Inventarizimit.

Nr. i Gjetjes 6	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE BARMASH-NOVOSELË
Njësitë/ subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Njësia Administrative Bramash-Novoselë; • Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” (i ndryshuar) i Ministrisë së Financave.

Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Nga inventarizimi i kryer në vitin 2023 me Urdhër Nr. 62, datë 25.01.2024 “Për ngritjen e komisioneve të vlerësimit të aktiveve”, komisionet kanë bërë vlerësimin e aktiveve për Njësinë Administrative Barmash-Novoselë, si në përmbledhësin më poshtë vijon, por nuk është ngritur Komisioni për Nxjerrjen Jashtë Përdorimit të Aktiveve të konstatuara si të tilla nga Komisioni i Inventarizimit.</p> <p>Kriteri: Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” (<i>i ndryshuar</i>) i Ministrisë së Financave.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Megjithëse është kryer një inventarizim i aktiveve për Njësinë Administrative Barmash-Novoselë dhe komisionet kanë realizuar vlerësimin e tyre, nuk është ngritur një komision për nxjerrjen jashtë përdorimit të atyre aktiveve që janë konstatuar si të papërdorshme nga Komisioni i Inventarizimit. Kjo ka pasoja negative, pasi nuk mund të realizohet një menaxhim i duhur i pasurisë publike dhe mund të sjellë grumbullimin e pasurive të panevojshme që ndihmojnë vetëm në rritjen e kostove administrative dhe mund të bllokojnë përdorimin efektiv të resurseve.</p> <p>Shkaku: Neglizhenca në përmbushjen e detyrave ligjore.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i lartë.
Konkluzioni	Pengimi në realizimin e një administrimi efikas të resurseve dhe ka mundësuar grumbullimin e aktiveve të panevojshme, që mund të çojnë në rritjen e kostove dhe në keqmenaxhim të pasurisë publike.
Rekomandimi	Të ngrihet komision për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve publike të Njësisë Administrative Bramash-Novoselë, në zbatim të paragrafëve 107, 108 dhe 109 të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” (<i>i ndryshuar</i>) i Ministrisë së Financave.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Brenda 6-mujorit të parë të 2025.
Statusi i rekomandimit	Është paraqitur Observacion.

Nr.	Llogaria	Gjendje në fillim të vitit	Furnizim	Nxjerrje nga komisioni	Gjendje në fund të vitit
1.	327	377404.4		12660	377404.4
2.	218	1139154		150914	1139154

Tab. 1 Njësia Administrative Barmash

Nr.	Llogaria	Gjendje në fillim të vitit	Furnizim	Nxjerrje nga komisioni	Gjendje në fund të vitit
1.	327	386482	384	32149	386866
2.	218	855713			855713

Tab. 2 Njësia administrative Novoselë

29. **Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:** Në përgjithësi, auditimi i sistemeve dhe proceseve të administratës në Njësitë Administrative Barmash-Novoselë dhe Novoselë ka nxjerrë në pah disa mangësi dhe shkelje të ligjit, të cilat ndikojnë në efikasitetin dhe funksionimin e duhur të këtyre njësive. Gjetjet kanë theksuar mangësi në administrimin e dokumenteve, vlerësimin e performancës së punonjësve, trajnimin e stafit dhe menaxhimin e aktiveve. Nuk është siguruar dokumentacion i plotë për të vërtetuar përfundimin e studimeve të administratorit, një neglizhencë që mund të ndikojë negativisht në vërtetimin e kualifikimeve dhe mundësitë e verifikimit të aftësive profesionale të punonjësve. Administratori nuk ka marrë vlerësim të detajuar të punës së tij, duke e bërë të vështirë vlerësimin e performancës dhe motivimin e stafit. Kjo është një shkelje e kërkesave të ligjit për vlerësimin e punonjësve dhe ka ndikim në menaxhimin e performancës. Rregullorja e brendshme aktuale nuk përcakton qartë funksionet dhe përgjegjësitë e administratorëve, duke sjellë paqartësi dhe vështirësi në menaxhimin e administratës. Kjo mund të krijojë konfuzion dhe pengesa në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive. Nuk janë ofruar trajnime të nevojshme për staf, veçanërisht në fushën e legjislacionit administrativ. Kjo ka sjellë boshllëqe në aftësitë e stafit dhe mund të ketë pasuar me gabime ligjore dhe vonesa në implementimin e detyrave administrative. Njësia ka patur një numër të ulët punonjësish, duke krijuar ngarkesë të madhe për personelin e mbetur dhe duke reduktuar efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve. Nuk është mbushur vakanca e krijuar pas emërimit të administratorit në një pozicion tjetër, duke ndikuar në menaxhimin e duhur të punëve dhe proceseve administrative. Megjithatë është kryer inventarizimi, nuk është ngritur një komision për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve që janë konstatuar si të papërdorshme. Kjo ka shkaktuar grumbullimin e pasurive të panevojshme dhe mund të rrisë kostot administrative, duke penguar menaxhimin efikas të pasurive publike.

30. 4.2 SISTEMI I KRIJIMIT DHE IMPLEMENTIMIT TË SISTEMEVE

7. **Titulli i Gjetjes:** Mungon dokumentimi i punës së Njesisë Administrative për rastet e bashkëpunimit me institucionet e tjera.

Nr. i Gjetjes 7	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE BARMASH- NOVOSELË
Njësitë/ subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> Njësia Administrative Barmash-Novoselë; Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar)
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Nga intervistat e zhvilluara verbalisht, rezulton se ka bashkëpunim midis Njësive Administrative me njëra-tjetrën si dhe Njësive me Bashkinë (Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Sektorin e Emergjencave Civile, Bordin e Kullimit, Sektorin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi etj.), por kjo gjë nuk është dokumentuar nga

	<p>ana e administratorit.</p> <p>Kriteri: Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar).</p> <p>Ndikimi/Efekti: Është e vështirë të përcaktohet nëse dhe sa efektivisht bashkëpunojnë njësitë dhe pa evidenca të qarta mbi bashkëpunimin, është e vështirë të vlerësohet ndikimi i tij dhe të bëhen përmirësime të nevojshme.</p> <p>Shkaku: Neglizhenca në kryerjen e detyrave dhe moszbatimi i parashikimeve ligjore.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i lartë
Konkluzioni	Nga analiza e situatës, rezulton se bashkëpunimi midis Njesisë Administrative dhe Bashkisë ekziston, por mungesa e dokumentimit të tij krijon sfida në transparencë, llogaridhënie dhe menaxhimin e shërbimeve publike. Kjo mungesë vjen kryesisht nga faktorë si përdorimi i komunikimit verbal, mungesa e procedurave të qarta, kapacitetet e kufizuara administrative dhe mungesa e një sistemi të integruar për dokumentim.
Rekomandimi	Të merren masa për mbajtje të rregullt të dokumentacionit për të pasqyruar drejt rastet e bashkëpunimit mes njësive me njëra-tjetrën dhe Bashkinë.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Është paraqitur Observacion.

8. Titulli i Gjetjes: Nuk janë dixhitalizuar proceset e punës dhe ofrimit të shërbimeve.

Nr. i Gjetjes 8	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE BARMASH- NOVOSELË
Njësitë/ subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Njësia Administrative Barmash-Novoselë; • Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar). • Ligji Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar).
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Proceset e punës dhe ofrimit të shërbimeve nuk janë dixhitalizuar për shkak të mungesës së infrastrukturës.</p> <p>Kriteri: Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar).</p> <p>Ligji Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar).</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mungesa e dixhitalizimit për shkak të infrastrukturës së pamjaftueshme shkakton vonesa, rritje të kostove dhe mungesë transparence në ofrimin e shërbimeve publike. Kjo situatë pengon koordinimin institucional dhe e</p>

	bën më të vështirë qasjen e qytetarëve në shërbime efikase dhe të automatizuara. Shkaku: Kapacitetet e kufizuara administrative dhe financiare.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i mesëm.
Konkluzioni	Mungesa e dixhitalizimit për shkak të infrastrukturës së pamjaftueshme ndikon negativisht në efikasitetin, transparencën dhe qasjen e qytetarëve ndaj shërbimeve publike. Për të përmirësuar këtë situatë, nevojiten investime në teknologji, trajnime për stafin dhe krijimi i një platforme të unifikuar dixhitale.
Rekomandimi	Të merren masa që në momentin e azhornimit të infrastrukturës për dixhitalizimin e shërbimeve në Bashki, të merren në konsideratë edhe nevojat e Njësive Administrative.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Është paraqitur Observacion.

31. **Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:** Në bazë të intervistave të zhvilluara, ka bashkëpunim mes Njësive Administrative dhe institucioneve të Bashkisë, por ky bashkëpunim nuk është dokumentuar nga administratorët, duke e bërë të vështirë monitorimin dhe vlerësimin. Rekomandohet mbajtja e dokumentacionit të rregullt për bashkëpunimin mes njësive dhe Bashkisë.

Sa i përket dixhitalizimit, mungesa e infrastrukturës ka penguar proceset e punës dhe ofrimin e shërbimeve. Rekomandohet që në momentin e përditësimit të infrastrukturës, të merren parasysh nevojat për dixhitalizimin e shërbimeve në Njësitë Administrative.

Afatet dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara, por është e rëndësishme të sigurohet angazhim i vazhdueshëm për realizimin e këtyre masave.

32. 4.3 SISTEMI I PËRPUTHSHMËRISË ME RREGULLORET DHE PROCEDURAT

Njësia Administrative funksionon në përputhje me parashikimet e bëra në nenin 66 të Ligjit Nr. 114/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar), i cili parashikon si detyra të Njësive Administrative:

- a) është zyrë e shërbimit për të gjitha procedurat administrative në kompetencën e bashkisë;

- b) mbikëqyr territorin për zbatimin e ligjit në të gjitha fushat në kompetencën e bashkisë dhe njofton strukturat kompetente të bashkisë në rast të konstatimit të veprimeve në kundërshtim me ligjin;
- c) mbështet punën e strukturave kompetente të bashkisë;
- ç) bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë, mund të administrojë parqet, lulishtet dhe zonat e gjelbëruara;
- d) bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë, mund të administrojë tregjet publike;
- dh) bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë, mund të administrojë këndet e lojërave, terrenet sportive, bibliotekat, shtëpitë dhe klubet e rinisë;
- e) përgatit dhe i propozon kryetarit të bashkisë planin për investimet nën juridiksionin e saj territorial, si dhe mbikëqyr, pas miratimit, zbatimin e tyre, sipas ligjit;
- ë) propozon, sipas ligjit, emërtimin e rrugëve, shesheve, institucioneve dhe objekteve që janë nën juridiksionin e saj territorial;
- f) mbështet, koordinon dhe mbikëqyr veprimtarinë e kryetarëve e të kryesive të fshatrave;
- g) i propozon kryetarit të bashkisë dhënien e titujve të nderit dhe stimujve për personat nën juridiksionin e saj territorial;
- gj) propozon marrjen e nismave në dobi të komunitetit me mundësi të barabarta dhe përfitime nga të gjithë brenda juridiksionit të saj territorial;
- h) kryen çdo funksion tjetër të deleguar nga kryetari i bashkisë.

9. Titulli i Gjetjes: Njësia nuk ka respektuar asnjë nga parashikimet e nenit 66 të Ligjit Nr. 114/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar).

Nr. i Gjetjes 9	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE BARMASH- NOVOSELË
Njësitë/ subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Njësia Administrative Barmash-Novoselë; • Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Ligjit Nr. 114/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar)
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Me aq sa del nga dokumentacioni i dorëzuar Njësia nuk ka respektuar asnjë nga parashikimet e nenit 66 të Ligjit Nr. 114/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar).</p> <p>Kriteri: Neni 66 të Ligjit Nr. 114/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar).</p> <p>Ndikimi/Efekti: Ky mosrespektim mund të çojë në shkelje procedurale, ulje të efikasitetit dhe humbje besimi nga qytetarët dhe institucionet mbikëqyrëse.</p> <p>Shkaku: Mosnjohja e parashikimeve ligjore.</p>

Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i lartë
Konkluzioni	Mospërmbushja e detyrimeve të nenit 66 të Ligjit Nr. 114/2015 nga Njësia dëmton transparencën, llogaridhënien dhe funksionimin e saj ligjor. Për të shmangur pasojat negative, është e nevojshme që Njësia të zbatojë detyrimet ligjore dhe të marrë masa korrigjuese për përmirësimin e qeverisjes vendore.
Rekomandimi	Të merren masa për plotësimin e detyrave ligjore dhe dokumentimin e punës së kryer në bazë dhe në zbatim të ligjit.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi
Statusi i rekomandimit	Është paraqitur Observacion.

33. Me shkresën Nr. 5645/1 Prot., datë 10.12.2024, Administratori i Njesisë Administrative Barmash-Novoselë, ka vënë në dispozicion të Njesisë së Auditit të Brendshëm dokumentacionin e nxjerrë gjatë periudhës 01.01.2024-11.11.2024 nga kjo Njësi.

10. Titulli i Gjetjes: Mungon Regjistri i Korrespondencës (Protokollit) i Njesisë Administrative.

Nr. i Gjetjes 10	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE BARMASH- NOVOSELË
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> Njësia Administrative Barmash-Novoselë; Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> VKM Nr. 4 datë 19.06.2017 për miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Mungon Regjistri i Korrespondencës (Protokollit) i Njesisë Administrative, në kundërshtim me parashikimet ligjore dhe kërkesat e nenit 11 të VKM Nr. 4 datë 19.06.2017 për miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”. Për sa më sipër, parashikohet detyrimi që të gjitha aktet zyrtare që krijohen ose vijnë në një institucion publik, evidentohen në Rregjistrin e Korrespondencës si mjet për të vërtetuar autencitetin e tyre. Nga dokumentacioni i dorëzuar, rezulton se Njësia vetëm ka krijuar dokumenta dhe nuk i ka ardhur asnjë dokument i jashtëm.</p> <p>Kriteri: VKM Nr. 4 datë 19.06.2017 për miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mungesa e Regjistrit të Korrespondencës (Protokollit) në</p>

	Njësinë Administrative, përkundër kërkesave ligjore dhe rregullave të parashikuara nga VKM Nr. 4, ndikon negativisht në vërtetimin e autencitetit të dokumenteve dhe mund të çojë në mungesë kontrolli dhe transparence. Ky veprim shkel kërkesat për dokumentimin e të gjitha aktve zyrtare, duke krijuar mundësi për keqmenaxhim dhe abuzime me detyrën, si dhe mund të ndikojë në efikasitetin e administratës publike dhe marrëdhëniet me qytetarët dhe institucionet e tjera. Shkaku: Mosnjohja e parashikimeve ligjore.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i lartë.
Konkluzioni	Mungesa e një regjistri të korrespondencës të krijon një boshllëk në dokumentimin dhe monitorimin e aktve zyrtare, çka ndikon në shkeljen e ligjit dhe mungesën e transparencës. Për të siguruar një administratë të përgjegjshme dhe të ligjshme, është e domosdoshme që Njësia Administrative të krijojë dhe të mbajë një regjistër të plotë dhe funksional të korrespondencës, në përputhje me parashikimet ligjore.
Rekomandimi	Të mbahet Regjistri i Korespondencës (Protokollit) në përputhje me kërkesat e nenit 11 të VKM Nr. 4 datë 19.06.2017 për miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë dhe në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Është paraqitur Observacion.

11. Titulli i Gjetjes: Dokumentacioni i nxjerrë me datë dhe numër protokollit të shkruar me mjete elektronike.

Nr. Gjetjes 11	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE BARMASH- NOVOSELË
Njësitë/ subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Njësia Administrative Barmash-Novoselë; • Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Manual Trajnimi Për Punonjësit e Zyrës së Arkivit dhe Protokollit të Njësive të Qeverisjes Vendore.
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Në total Njësia ka nxjerrë 49 dokumenta nga të cilat 40 vijnë në kundërshtim me parashikimet ligjore dhe përcaktimet në “Manual Trajnimi Për Punonjësit e Zyrës së Arkivit dhe Protokollit të Njësive të Qeverisjes Vendore”, i cili parashikon se “ <i>data dhe numri i protokollit vendoset gjithmonë pas firmosjes nga titullari</i> ”. Për sa më sipër, një pjesë e vërtetimeve, sikurse paraqitet në tabelen

	<p>e mëposhtme, nuk kanë dale konform me këtë parashikim, pasi numri i protokollit është vendosur me pajisje elektronike dhe më pas është nënshkruar dokumenti nga Administratori.</p> <p>Kriteri: Manual Trajnimi Për Punonjësit e Zyrës së Arkivit dhe Protokollit të Njësive të Qeverisjes Vendore.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Dëmton integritetin e dokumenteve dhe të krijojë pasiguri në lidhje me autencitetin e tyre. Vendosja e numrit të protokollit përmes pajisjeve elektronike para firmosjes nga titullari bie ndesh me rregullat e parashikuara dhe mund të çojë në probleme në kontrollin dhe verifikimin e dokumenteve, duke e bërë të vështirë ndjekjen e historikut të aktit dhe procesin e auditimit.</p> <p>Shkaku: Mosnjohja e parashikimeve ligjore dhe neglizhenca në kryerjen e detyrave funksionale.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i lartë.
Konkluzioni	Shkelja e procedurës për vendosjen e numrit të protokollit ka një ndikim negativ në besueshmërinë e dokumenteve dhe mund të çojë në probleme të mundshme ligjore dhe administrative. Është thelbësore që Njësia të zbatojë në mënyrë strikte procedurat e protokollimit, përfshirë vendosjen e numrit të protokollit pas firmosjes nga titullari, në përputhje me manualin dhe kërkesat ligjore.
Rekomandimi	Të merren masa për zbatimin e Manualit të Trajnimit Për Punonjësit e Zyrës së Arkivit dhe Protokollit të Njësive të Qeverisjes Vendore për të respektuar kërkesat ligjore mbi formatin e shkresave zyrtare.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi
Statusi i rekomandimit	Është paraqitur Observacion.

Nr.	DOKUMENTI
1.	Vërtetim Nr.3 Prot., datë 27.03.2024
2.	Vërtetim Nr.4 Prot., datë 27.03.2024
3.	Vërtetim Nr.5 Prot., datë 29.03.2024
4.	Vërtetim Nr.71 Prot., datë 18.01.2024
5.	Vërtetim Nr.72 Prot., datë 02.02.2024
6.	Vërtetim Nr.73 Prot., datë 14.02.2024
7.	Vërtetim Nr.76 Prot., datë 29.03.2024
8.	Vërtetim Nr.93 Prot., datë 31.05.2024
9.	Vërtetim Nr.112 Prot., datë 12.06.2024
10.	Vërtetim Nr.134 Prot., datë 02.07.2024
11.	Vërtetim Nr.140 Prot., datë 02.08.2024
12.	Vërtetim Nr.141 Prot., datë 07.08.2024
13.	Karakteristikë Nr.145 Prot., datë 09.08.2023

14.	Vërtetim Nr.150 Prot., datë 28.08.2024
15.	Vërtetim Nr.151 Prot., datë 04.09.2024
16.	Vërtetim Nr.152 Prot., datë 10.09.2024
17.	Vërtetim Nr.153 Prot., datë 16.09.2024
18.	Vërtetim Nr.154 Prot., datë 16.09.2024
19.	Vërtetim Nr.158 Prot., datë 24.09.2024
20.	Vërtetim Nr.159 Prot., datë 24.09.2024
21.	Vërtetim Nr.160 Prot., datë 26.09.2024
22.	Vërtetim Nr.161 Prot., datë 26.09.2024
23.	Vërtetim Nr.162 Prot., datë 26.09.2024
24.	Vërtetim Nr.163 Prot., datë 26.09.2024
25.	Vërtetim Nr.164 Prot., datë 26.09.2024
26.	Vërtetim Nr.166 Prot., datë 30.09.2024
27.	Vërtetim Nr.167 Prot., datë 30.09.2024
28.	Vërtetim Nr.168 Prot., datë 30.09.2024
29.	Vërtetim Nr.169 Prot., datë 30.09.2024
30.	Vërtetim Nr.170 Prot., datë 30.09.2024
31.	Vërtetim Nr.171 Prot., datë 02.10.2024
32.	Vërtetim Nr.172 Prot., datë 02.10.2024
33.	Vërtetim Nr.173 Prot., datë 09.10.2024
34.	Vërtetim Nr.175 Prot., datë 11.10.2024
35.	Vërtetim Nr.176 Prot., datë 14.10.2024
36.	Vërtetim Nr.177 Prot., datë 14.10.2024
37.	Vërtetim Nr.178 Prot., datë 14.10.2024
38.	Vërtetim Nr.181 Prot., datë 28.10.2024
39.	Vërtetim Nr.184 Prot., datë 12.11.2024
40.	Vërtetim Nr.185 Prot., datë 12.11.2024

12. Titulli i Gjetjes: Mungesa e rakordimit të numrave të protokollit midis dokumentave.

Nr. i Gjetjes 12	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE BARMASH- NOVOSELË
Njësitë/ subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Njësia Administrative Barmash-Novoselë; • Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Manual Trajnimi Për Punonjësit e Zyrës së Arkivit dhe Protokollit të Njësive të Qeverisjes Vendore.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Mungon rakordimi midis numrit të protokollit dhe datës së dokumentit në dokumentat sipas tabelës më poshtë. Shkresa e parë e krijuar nga Njësia Administrative për vitin 2024 që i është vënë në dispozicion Njesisë së Auditit të Brendshëm mban numër rendor protokollimi më të madh (Nr. 71 Prot., datë 18.01.2024) sesa shkresat e krijuara në muajt pasues, përkatësisht në muajin Mars</p>

	<p>të cilat mbajnë numrat e protokollit 3, 4 dhe 5.</p> <p>Për keto arsye, Njësia e Auditit të Brendshëm dyshon për vërtetësinë e këtyre dokumentave.</p> <p>Kriteri: Manual Trajnimi Për Punonjësit e Zyrës së Arkivit dhe Protokollit të Njësive të Qeverisjes Vendore.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mungesa e rakordimit midis numrit të protokollit dhe datës së dokumentit krijon pasiguri në lidhje me vërtetësinë dhe renditjen e dokumenteve, duke ngjallur dyshime për manipulim të mundshëm ose shkelje të procedurave të protokollimit. Kjo çon në vështirësi për Njësia e Auditit të Brendshëm për të verifikuar integritetin dhe kronologjinë e dokumenteve, dhe mund të shkaktojë humbje besimi në procesin e menaxhimit të dokumenteve dhe auditimin e tyre.</p> <p>Shkaku: Mosnjohja e parashikimeve ligjore dhe neglizhenca në kryerjen e detyrave funksionale.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i lartë.
Konkluzioni	Mungesa e rakordimit midis numrit të protokollit dhe datës së dokumentit dëmton besueshmërinë dhe verifikueshmërinë e dokumenteve, duke krijuar dyshime për manipulim. Për të parandaluar pasojat e mundshme ligjore dhe administrative, është e domosdoshme që Njësia të sigurojë një sistem të saktë dhe të qëndrueshëm protokollimi, ku numri dhe data të jenë në përputhje me njëra-tjetrën.
Rekomandimi	Në gjykimin e Njësies së Auditit të Brendshëm ky fakt përbën shkelje të detyrimit të kujdesit në punë sipas nenit 24 të Kodit të Punës, për këtë arsye kërkojmë nga ana e Titullarit, si eprori direkt, të marrë masë disiplinore “Vërejtje me shkrim” për Z. Petro Kristo.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë.
Statusi i rekomandimit	Është paraqitur Observacion.

Nr.	DOKUMENTI
1.	Vërtetim Nr.3 Prot., datë 27.03.2024
2.	Vërtetim Nr.4 Prot., datë 27.03.2024
3.	Vërtetim Nr.5 Prot., datë 29.03.2024
4.	Vërtetim Nr.71 Prot., datë 18.01.2024
5.	Vërtetim Nr.72 Prot., datë 02.02.2024
6.	Vërtetim Nr.73 Prot., datë 14.02.2024
7.	Vërtetim Nr.76 Prot., datë 29.03.2024

13. Titulli i Gjetjes: Mungesa e vulës së Institucionit në Shkresën Përcjellëse Nr.5645/1Prot., datë 10.12.2024.

Nr. i Gjetjes 13

Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE BARMASH-NOVOSELË
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Njësia Administrative Barmash-Novoselë ; • Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Manual Trajnimi Për Punonjësit e Zyrës së Arkivit dhe Protokollit të Njësive të Qeverisjes Vendore.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Shkresa Nr. 145 Prot., datë 09.08.2023 i është vënë në dispozicion Njesisë së Auditimit të Brendshëm me Shkresën Përcjellëse Nr.5645/1Prot., datë 10.12.2024 me të cilën është dërguar dokumentacioni i krijuar në vitin 2024 dhe po aq kësaj shkrese e cila ka dalë nga Administratori, i mungon vula e institucionit.</p> <p>Kriteri: Manual Trajnimi Për Punonjësit e Zyrës së Arkivit dhe Protokollit të Njësive të Qeverisjes Vendore.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mungesa e vulës së institucionit në dokumentin e dërguar krijon dyshime mbi autencitetin e tij dhe mund të ndikojë negativisht në vlerësimin dhe pranimin e dokumentit si provë të vlefshme. Kjo mungesë shkel procedurat standarde të administratës dhe mund të shkaktojë probleme gjatë auditimit, duke e vështirësuar procesin e verifikimit të dokumenteve dhe duke reduktuar besueshmërinë e tyre.</p> <p>Shkaku: Mosnjohja e parashikimeve ligjore dhe neglizhenca në kryerjen e detyrave funksionale.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i lartë.
Konkluzioni	Mungesa e vulës së institucionit në shkresën e dërguar shkel procedurat dhe ka ndikim të drejtpërdrejtë në vërtetësinë e dokumenteve. Për të siguruar validitetin dhe transparencën e proceseve, është thelbësore që të gjitha dokumentet zyrtare të jenë të vulosura dhe të përmbushin kërkesat ligjore dhe administrative.
Rekomandimi	Të vlerësohet autenciteti i dokumentit dhe të merren masa për të konstatuar pavlefshmërinë e aktit duke qënë se i mungon një element thelbësor formal.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë.
Statusi i rekomandimit	Është paraqitur Observacion.

14. Titulli i Gjetjes: Mungesa e Kontratave të Qirasë për Fermerët për aplikimet për subvencione në dokumentacionin e mbajtur nga Administratori.

Nr. i Gjetjes 14

Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE BARMASH-NOVOSELË
Njësitë/ subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> Njësia Administrative Barmash-Novoselë; Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar).
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Në shkresën përcjellëse të dokumentacionit të dorëzuar, në paragrafin e dytë parashikohet se “<i>bashkëngjitur gjenden edhe Kontratat e Qirasë të fermerëve për aplikime në subvencione</i>”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se këto kontrata mungojnë.</p> <p>Kriteri: Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar).</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mungesa e kontratave të qirasë të fermerëve, të cilat ishin të përfshira në dokumentacionin e dorëzuar, ka ndikim të drejtpërdrejtë në procesin e auditimit dhe vlerësimin të aplikimeve për subvencione. Ky dokumentacion i paplotë mund të çojë në vështirësi në verifikimin e përmbushjes së kushteve për subvencione dhe të krijojë dyshime për përputhshmërinë me kriteret ligjore dhe procedurale.</p> <p>Shkaku: Neglizhenca në kryerjen e detyrave funksionale.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i lartë
Konkluzioni	Mungesa e kontratave të qirasë në dokumentacionin e dorëzuar shkel procedurat dhe ka ndikim negativ në transparencën dhe vlefshmërinë e aplikimeve për subvencione. Është e domosdoshme që të sigurohet dorëzimi i dokumenteve të plota dhe të përputhshme me kërkesat ligjore për të garantuar integritetin e procesit.
Rekomandimi	Të merren masa për vënien në dispozicion të NJAB-së kopje të njëhësuar me origjinalin të kontratave të qirasë së fermerëve për aplikimet në subvencione.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë
Statusi i rekomandimit	Është paraqitur Observacion.

15. Titulli i Gjetjes: Mungojnë evidencat për kontrollin mbi detyrimet e prapambetura për pajisjen me vërtetime të qytetarëve.

Nr. i Gjetjes 15	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE BARMASH-NOVOSELË

Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> Njësia Administrative Barmash-Novoselë; Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> Ligji Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (<i>i ndryshuar</i>).
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Nga dokumentacioni i dorëzuar mungojnë evidencat për kontrollin mbi detyrimet e prapambetura për pajisjen me vërtetime të qytetarëve.</p> <p>Kriteri: Ligji Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (<i>i ndryshuar</i>).</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mungesa e evidencave për kontrollin mbi detyrimet e prapambetura në pajisjen me vërtetime krijon pasiguri dhe mund të çojë në lëshimin e dokumenteve zyrtare pa verifikimin e duhur. Kjo mungesë rrezikon transparencën dhe ligjshmërinë e procesit administrativ, duke mundësuar pajisjen e individëve me vërtetime edhe nëse ata kanë detyrime të papaguara.</p> <p>Shkaku: Neglizhenca në kryerjen e detyrave funksionale.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i lartë.
Konkluzioni	Mungesa e evidencave mbi kontrollin e detyrimeve të prapambetura cenon integritetin dhe besueshmërinë e procesit të pajisjes me vërtetime. Për të shmangur keqadministrimin dhe abuzimet e mundshme, është e nevojshme të krijohet dhe zbatohet një sistem i rregullt i verifikimit të detyrimeve përpara lëshimit të dokumenteve.
Rekomandimi	Të merren masa për të plotësuar dokumentacionin.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Është paraqitur Observacion.

16. Titulli i Gjetjes: Aktet nuk janë nxjerrë të protokolluara në rend numerik dhe nga një akt te tjetri ka mungesa.

Nr. i Gjetjes 16	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE BARMASH- NOVOSELË
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> Njësia Administrative Barmash-Novoselë Bashkia Kolonjë
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> Ligji Nr. 1954/2003 “Për Arkivat” (<i>i ndryshuar</i>); Manual Trajnimi Për Punonjësit e Zyrës së Arkivit dhe Protokollit të Njësive të Qeverisjes Vendore.

Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Dokumentacioni nuk është mbajtur në mënyrë të rregullt, pasi aktet nuk janë nxjerrë të protokolluara në rend numerik dhe nga një akt te tjetri ka mungesa. Akti i fundit i nxjerrë më datë 12.11.2024 mban numrin e protokollit 185, gjë kjo që nënkupton se Njësia ka krijuar për vitin 2024, 185 akte, por nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultojnë vetëm 49 akte.</p> <p>Kriteri: Ligji Nr. 1954/2003 “Për Arkivat” <i>(i ndryshuar)</i>; Manual Trajnimi Për Punonjësit e Zyrës së Arkivit dhe Protokollit të Njësive të Qeverisjes Vendore.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mungesa e mbajtjes së rregullt të dokumentacionit dhe mosrespektimi i rendit numerik në protokoll krijojnë paqartësi dhe dyshime mbi integritetin dhe transparencën e procesit administrativ. Diferenca midis numrit të akteve të krijuara dhe atyre të vëna në dispozicion sugjeron keqadministrim ose mungesë të ruajtjes së dokumenteve, gjë që mund të pengojë auditimin dhe llogaridhënien institucionale.</p> <p>Shkaku: Neglizhenca në kryerjen e detyrave funksionale.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i lartë.
Konkluzioni	Dokumentacioni i parregullt dhe mungesa e akteve të plota cenojnë transparencën dhe vlefshmërinë e procesit administrativ. Është e nevojshme të përmirësohet sistemi i arkivimit dhe protokollimit për të garantuar ruajtjen dhe gjurmueshmërinë e dokumenteve zyrtare.
Rekomandimi	Të merren masa për të vendosur në dispozicion të NJAB-së aktet që mungojnë.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Është paraqitur Observacion.

17. Titulli i Gjetjes: Njësia nuk ka raportuar periodikisht mbi veprimtarinë e kryer prej saj gjatë vitit 2024.

Nr. i Gjetjes 17	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE BARMASH-NOVOSELË
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> Njësia Administrative Barmash-Novoselë ; Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” <i>(i ndryshuar)</i>.

Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Nga dokumentacioni i dorëzuar del se Njësia nuk ka raportuar periodikisht mbi veprimtarinë e kryer prej saj gjatë vitit 2024.</p> <p>Kriteri: Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” <i>(i ndryshuar)</i>.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mungesa e raportimit periodik për veprimtarinë e Njesisë gjatë vitit 2024 kufizon transparencën dhe llogaridhënien institucionale, duke e bërë të vështirë monitorimin e performancës dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore. Kjo mund të çojë në mungesë kontrolli dhe vlerësimi të duhur mbi veprimtarinë e institucionit, duke rritur rrezikun e keqadministrimit.</p> <p>Shkaku: Neglizhenca në kryerjen e detyrave funksionale.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i mesëm.
Konkluzioni	Mosraportimi periodik cenon transparencën dhe efektivitetin e qeverisjes vendore. Për të siguruar menaxhim të mirë dhe përputhshmëri me kërkesat ligjore, është e nevojshme vendosja e një praktike të rregullt raportimi dhe monitorimi të veprimtarisë së Njesisë.
Rekomandimi	Të merren masa për raportim periodik çdo 6 muaj mbi veprimtarinë e Njesisë.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Është paraqitur Observacion.

18. Titulli i Gjetjes: Njësia nuk ka marrë asnjë masë për adresimin e problematikave dhe boshllëqeve që janë hasur në zbatimin e detyrave ligjore.

Nr. i Gjetjes 18	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE BARMASH- NOVOSELË
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Njësia Administrative Barmash-Novoselë; • Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” <i>(i ndryshuar)</i>.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Nga dokumentacioni i dorëzuar del se Njësia nuk ka marrë asnjë masë për adresimin e problematikave dhe boshllëqeve që janë hasur në zbatimin e detyrave ligjore.</p> <p>Kriteri: Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” <i>(i ndryshuar)</i>.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mospërgjigja ndaj problematikave dhe boshllëqeve të evidentuara në zbatimin e detyrave ligjore tregon neglizhencë institucionale dhe mungesë përgjegjshmërie. Kjo situatë mund të çojë në përsëritjen e gabimeve,</p>

	uljen e efektivitetit administrativ dhe cenimin e besimit të publikut te institucioni. Shkaku: Neglizhenca në kryerjen e detyrave funksionale.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i mesëm.
Konkluzioni	Mungesa e masave për adresimin e problematikave pengon përmirësimin e performancës institucionale dhe rrit rrezikun e keqadministrimit. Është e domosdoshme që Njësia të vendosë një mekanizëm të rregullt për identifikimin dhe zgjidhjen e mangësive në përputhje me detyrimet ligjore.
Rekomandimi	Të merren masa për adresimin e problematikave dhe boshllëqeve të hasura si dhe të mbahet dokumentacion shoqërues.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Është paraqitur Observacion.

34. *Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:* Njësia Administrative ka paraqitur disa mangësi të konsiderueshme në lidhje me respektimin e ligjeve dhe rregullave të miratuara, si dhe në dokumentimin dhe raportimin e aktiviteteve të saj. Gjatë periudhës së shqyrtuar, janë identifikuar disa shkelje në lidhje me: mungesën e regjistrit të korrespondencës, moszbatimin e kërkesave të Manualit të Trajnimit për Arkiv dhe Protokollin, si dhe për pasaktësitë në numerimin dhe datimin e dokumenteve zyrtare.

Një shqetësim tjetër është mungesa e vulës institucionale në disa dokumente, çka vë në dyshim autenticitetin e këtyre akteve dhe mund të sjellë pasoja ligjore për Njësinë. Po ashtu, ka pasur parregullsi në protokollimin dhe renditjen e numrave të dokumenteve, që krijon dyshime mbi vërtetësinë e disa prej tyre.

35. 4.4 SISTEMI I SHERBIMEVE DHE NDIKIMIT MBI QYTETARET

19.Titulli i Gjetjes: Mungojnë kërkesat e qytetarëve apo kryepleqve të zonës për plotësimin e nevojave apo shërbimeve bazike

Nr. i Gjetjes 19	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE BARMASH- NOVOSELË
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Njësia Administrative Barmash-Novoselë; • Bashkia Kolonjë,

Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” <i>(i ndryshuar)</i>.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se ka mungesë të kërkesave të qytetarëve apo kryepleqve të zonës për plotësimin e nevojave apo shërbimeve bazike.</p> <p>Kriteri: Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” <i>(i ndryshuar)</i>.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mungesa e kërkesave nga qytetarët ose kryepleqtë e zonës tregon një defiçit në komunikimin dhe ndërveprimin midis komunitetit dhe Njësisë Administrative. Kjo mund të nënkuptojë mungesë informacioni mbi të drejtat dhe shërbimet e disponueshme ose mosbesim ndaj institucionit, duke ndikuar negativisht në ofrimin dhe përmirësimin e shërbimeve bazike.</p> <p>Shkaku: Neglizhenca në kryerjen e detyrave funksionale.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i mesëm.
Konkluzioni	Përmirësimi i kanaleve të komunikimit dhe informimit është thelbësor për të siguruar një administratë më transparente dhe efektive. Njësia duhet të ndërmarrë hapa për të inkurajuar qytetarët të shprehin nevojat e tyre dhe të rrisë ndërveprimin me komunitetin për një ofrim më të mirë të shërbimeve.
Rekomandimi	Të mbahet dokumentacioni i rregullt dhe të pasqyrojë kërkesat e qytetarëve dhe kryepleqve.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Është paraqitur Observacion.

36. **Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:** Nga analiza e dokumentacionit të dorëzuar, vërehet një mangësi në evidentimin e kërkesave të qytetarëve dhe kryepleqve për shërbime bazike, që mund të ndikojë në efikasitetin e ofrimit të shërbimeve për ta. Pavarësisht se shërbimet bazë mund të ofrohen, mungesa e dokumentacionit të rregullt lidhur me kërkesat tregon se mund të ketë një moskomunikim apo mungesë transparence në procesin e kërkesave dhe plotësimit të nevojave të qytetarëve.

37. 4.5 SISTEMI I RISKUT DHE SIFADAVE PËR FUNKSIONIMIN

20. **Titulli i Gjetjes:** Nuk janë dokumentuar kërkesat e banorëve për nxjerrjen e vërtetimeve.

Nr. i Gjetjes 20	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE BARMASH- NOVOSELË

Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> Njësia Administrative Barmash-Novoselë; Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar).
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Momentalisht, Njësia ofron shërbime vetëm të fokusuar në nxjerrjen e vërtetimeve për efekt dokumentacioni për banorët, megjithatë këto kërkesa nuk rezultojnë të dokumentuara.</p> <p>Kriteri: Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar).</p> <p>Ndikimi/Efekti: Fokusimi i Njesisë vetëm në nxjerrjen e vërtetimeve dhe mungesa e dokumentimit të këtyre kërkesave tregon një administrim të kufizuar dhe mungesë transparence. Kjo situatë rrezikon të krijojë paqartësi në ofrimin e shërbimeve dhe vështirësi në monitorimin e veprimtarisë institucionale.</p> <p>Shkaku: Neglizhenca në kryerjen e detyrave funksionale.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i mesëm.
Konkluzioni	Njësia duhet të zgjerojë gamën e shërbimeve dhe të krijojë një sistem të rregullt dokumentimi për të garantuar transparencë dhe efikasitet në administrim. Përmirësimi i regjistrimit të kërkesave do të ndihmonte në vlerësimin e nevojave të komunitetit dhe rritjen e llogaridhënies institucionale.
Rekomandimi	Të merren masa për dokumentimin e kërkesave të banorëve për nxjerrjen e vërtetimeve.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Është paraqitur Observacion.

21. Titulli i Gjetjes: Nuk është hartuar Regjistri i Riskut nga Njësia Administrative.

Nr. i Gjetjes 21	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE BARMASH- NOVOSELË
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> Njësia Administrative Barmash-Novoselë; Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (i ndryshuar),
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Nuk është hartuar Regjistri i Riskut për Njësinë Administrative Barmash-Novoselë, në shkelje të nenit 21 të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (i ndryshuar), parashikimeve të bëra</p>

	<p>në Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër Nr. 108, datë 17.11.2016 të Ministrit të Financave, si dhe duke mos përmbushur Rekomandimet e lëna nga Raporti Përfundimtar Nr. 186/19 Prot., datë 25.07.2024 i Kontrollit të Lartë të Shtetit.</p> <p>Kriteri: Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (<i>i ndryshuar</i>), Raporti Përfundimtar Nr. 186/19 Prot., datë 25.07.2024 i Kontrollit të Lartë të Shtetit.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mungesa e hartimit të Regjistrit të Riskut për Njësine Administrative Barmash-Novoselë tregon dobësi në menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Kjo rrit mundësinë e keqadministrimit të fondeve publike dhe ekspozon njësine ndaj risqeve operationale dhe financiare pa një mekanizëm të qartë për identifikimin dhe parandalimin e tyre.</p> <p>Shkaku: Neglizhenca në kryerjen e detyrave funksionale.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i lartë
Konkluzioni	Për të siguruar një menaxhim të qëndrueshëm dhe në përputhje me ligjin, Njësia duhet të hartojë dhe zbatojë sa më shpejt Regjistrin e Riskut. Kjo do të përmirësojë kontrollin mbi risqet dhe do të rrisë transparencën dhe përgjegjshmërinë në administrimin e burimeve publike.
Rekomandimi	Të merren masa për hartimin e Regjistrit të Riskut dhe rishikimin e tij 2 (dy) herë në vit.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Çdo 6 muaj brenda vitit 2025.
Statusi i rekomandimit	Është pranuar, nuk është paraqitur Observacion.

38. **Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:** Nga vlerësimi i mundësive për ndërhyrje dhe menaxhimin të risqeve, është e dukshme se ka disa mangësi që ndikojnë në efikasitetin dhe transparencën e procesit të ofrimit të shërbimeve. Në lidhje me kërkesat për nxjerrjen e vërtetimeve, vërehet se dokumentimi i këtyre kërkesave është i pamjaftueshëm, çka mund të shkaktojë vonesa ose mosmbajtjen e një rekordi të saktë të kërkesave të qytetarëve. Ky dokumentim është thelbësor për transparencën dhe efikasitetin e ofrimit të shërbimeve.

Sa i përket menaxhimin të risqeve, mungesa e Regjistrit të Riskut për Njësine Administrative Barmash-Novoselë është një shkelje e ligjit dhe normave të përcaktuara, që mund të rrisë rrezikun e mosmenaxhimit të duhur të risqeve financiare dhe operationale. Kjo gjithashtu ndikon negativisht në mundësinë për identifikimin dhe trajtimin e risqeve që mund të paraqiten në të ardhmen.

39. 4.6 SISTEMI I PLANIFIKIMIT DHE MENAXHIMIT TË BURIMEVE

22. Titulli i Gjetjes: Mungesë dokumentacioni në dosjen e personelit të Administratorit Z. Leonard Konica.

Nr. i Gjetjes 22	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR-LESKOVIK
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Njësia Administrative Qendër-Leskovik; • Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Ligjit Nr.139/2025 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar). • Ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar).
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: 1. Administratori është i emëruar me Urdhër të Kryetarit Nr. 11, datë 10.01.2022, sipas parashikimeve të pikës “ë” të nenit 64, të Ligjit Nr.139/2025 “Për vetëqeverisjen vendore”;</p> <p>2. Plotëson kriteret e pikës 2 të nenit 65 të Ligjit Nr.139/2025 “Për vetëqeverisjen vendore”, ka vendbanimin në Kolonjë sikurse del nga Certifikata personale e datës 20.01.2022.</p> <p>3. Jetëshkrimi mungon në dosjen e personelit.</p> <p>4. Mungon Kontrata e Punës për Administratorin.</p> <p>5. Për vitin 2024 nuk është bërë asnjë vlerësim i punës së kryer prej tij.</p> <p>Kriteri: Ligjit Nr.139/2025 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar).</p> <p>Ndikimi/Efekti: Emërimi i Administratorit sipas parashikimeve ligjore tregon se ka pasur një proces të rregullt dhe të ligjshëm për emërimin, duke siguruar që ai plotëson kriteret e përcaktuara nga Ligji Nr. 139/2025 "Për vetëqeverisjen vendore".</p> <p>Plotësimi i kriterëve ligjore për vendbanimin në Kolonjë, në përputhje me ligjin, mund të sigurojë përputhshmërinë me rregullat dhe normat që kërkohen për të mbajtur pozitat e tilla në administratën lokale.</p> <p>Mungesa e jetëshkrimit në dosjen e personelit mund të ndikojë në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar dhe mund të shkaktojë pasiguri në vlerësimin e kandidatëve për këtë pozitë. Ky mungesë mund të ndikojë në integritetin dhe transparencën e procesit të administratës.</p> <p>Shkaku: Neglizhenca në mbajtjen e rregullt të dokumentacionit dhe administrimin e tij nga ana e Njesisë Përgjegjëse.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i mesëm.
Konkluzioni	Duhet të ruhet dhe të sigurohet që të gjitha procedurat ligjore dhe rregulloret të respektohen, duke mbajtur një dokumentacion të plotë dhe të përditësuar për emërimet dhe kriteret për administratorët.

	Duhet të plotësohet dosja e personelit me jetëshkrimin e nevojshëm për të siguruar që çdo informacion për administratën të jetë i plotë dhe i saktë, duke ndihmuar në përputhshmërinë me standardet e administratës publike.
Rekomandimi	Të plotësohet dosja me jetëshkrimin për Administratorin dhe Kontratën e Punës dhe të merren masat për vlerësimin e punës së kryer prej tij.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë.
Statusi i rekomandimit	Është pranuar, nuk është paraqitur Observacion.

23. Titulli i Gjetjes: Mungesë dokumentacioni në dosjen e personelit të punonjësës Znj. Xheni Pina.

Nr. i Gjetjes 23	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR-LESKOVIK
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> Njësia Administrative Qendër-Leskovik; Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> Ligji Nr. 152/2013 “Për Nënpunësin Civil” (<i>i ndryshuar</i>).
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Specialist i Ndihmës Ekonomike është i emëruar me Akt Emërimi nga Njësia Përgjegjëse Nr. 240, datë 23.11.2016.</p> <p>2. Në CV ka të deklaruar aftësinë në gjuhë të huaj Anglisht, por dëshmia e njohjes së gjuhës së huaj mungon në dosjen e personelit.</p> <p>3. Vlerësimin e fundit në dosje e ka të vitit 2016. Për vitin 2024, rezulton se nuk është bërë asnjë vlerësim i punës së kryer duke shkelur parashikimet e bëra nga neni 62 i Ligjit Nr. 152/2013 “Për Nënpunësin Civil” (<i>i ndryshuar</i>).</p> <p>4. Nga dosja e personelit rezulton se znj. Xheni Pina gëzon statusin e nënpunësit civil të konfirmuar me Aktin Nr. 2369 Prot., datë 18.07.2019, megjithatë procedura e konfirmimit të nënpunësit mungon në dosjen e personelit.</p> <p>Kriteri: Ligji Nr. 152/2013 “Për Nënpunësin Civil” (<i>i ndryshuar</i>).</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mungesa e dokumenteve për procedurën e konfirmimit të nënpunësit civil, në kundërshtim me rregulloret dhe procedurat e përcaktuara, mund të ndikojë në ligjshmërinë e statusit të punonjësit dhe të shkaktojë probleme në administratën e tij të karrierës.</p> <p>Mungesa e dëshmive për njohjen e gjuhës së huaj Anglisht në dosjen e personelit mund të krijojë pasiguri lidhur me aftësitë e punonjësit, duke cënuar besueshmërinë e informacionit të dhënë dhe duke ndikuar në vlerësimin e tij profesional.</p> <p>Mosvlerësimi i punës për vitin 2024, në kundërshtim me parashikimet e ligjit, mund të çojë në mungesë përgjegjshmërie dhe transparence në vlerësimin e performancës së punonjësve dhe mund të ndikojë në motivimin dhe zhvillimin e</p>

	tyre profesional. Shkaku: Neglizhenca në mbajtjen e rregullt të dokumentacionit dhe administrimin e tij nga ana e Njesisë Përgjegjëse.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i mesëm.
Konkluzioni	Duhet të rishikohet dhe të plotësohet procedura e konfirmimit të nënpunësit civil, duke siguruar që dosja e personelit të përmbushë kërkesat ligjore dhe procedurale të nevojshme. Duhet të kërkohet dorëzimi i dëshmimeve të nevojshme për njohjen e gjuhës së huaj dhe të sigurohet që informacioni në CV të jetë i saktë dhe i përputhshëm me dokumentacionin. Duhet të realizohet një vlerësim i detajuar dhe i rregullt i punës për vitin 2024, për të siguruar përputhshmërinë me ligjin dhe për të rritur transparencën dhe përgjegjshmërinë në vlerësimin e punonjësve.
Rekomandimi	Të plotësohet dosja e personelit me dëshminë e njohjes së gjuhës së huaj anglisht, me dokumentacionin shoqërues të procedurës së pranimit në shërbimin civil si dhe të merren masat për kryerjen e vlerësimit të punës sipas parashikimeve ligjore.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë.
Statusi i rekomandimit	Është pranuar, nuk është paraqitur Observacion.

24. Titulli i Gjetjes: Mungesë dokumentacioni në dosjen e personelit të punonjësës Znj. Gerida Nure.

Nr. i Gjetjes 24	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR-LESKOVIK
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Njësia Administrative Qendër-Leskovik; • Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja për Pranimin në Detyrë të Punonjësit të Gjendjes Civile miratuar me Urdhërin Nr.1366 Prot., datë 19.08.2006 i Ministrit të Brendshëm.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: 1. Përgjegjës i Gjendjes Civile është i emëruar me Akt Emërimi nga Njësia Përgjegjëse Nr. 2777/1 Prot., datë 16.03.2023, por procedura e emërimit mungon në dosje, në kundërshtim me parashikimet e bëra nga Rregullorja për Pranimin në Detyrë të Punonjësit të Gjendjes Civile miratuar me Urdhërin Nr.1366 Prot., datë 19.08.2006 i Ministrit të Brendshëm.</p> <p>2. Në CV ka të deklaruar aftësinë në gjuhë të huaj Anglisht, por dëshmia e njohjes</p>

	<p>së gjuhës së huaj mungon në dosjen e personelit.</p> <p>3. Në CV ka të deklaruar se ka përfunduar vitin e parë të studimeve në Master i Shkencave në “Drejtim dhe menaxhim i mediave”, por në dosje mungon dokumentacioni që provon këtë fakt.</p> <p>Kriteri: Rregullorja për Pranimin në Detyrë të Punonjësit të Gjendjes Civile miratuar me Urdhërin Nr.1366 Prot., datë 19.08.2006 i Ministrisë të Brendshme.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mungesa e procedurës së emërimit për përgjegjësin e Gjendjes Civile, në kundërshtim me rregulloren për pranimin në detyrë, mund të çojë në shkelje të normave ligjore dhe administrative, duke e bërë të pasigurt të drejtën e tij për të ushtruar funksionin dhe duke cenuar transparencën e procesit të emërimit. Mungesa e dëshmisë për njohjen e gjuhës së huaj Anglisht, në kundërshtim me informacionin të dhënë në CV, mund të nënkuptojë se informacioni në dokumentacionin e personelit nuk është i saktë, duke krijuar dyshime mbi aftësitë reale të punonjësit. Mungesa e dokumentacionit që provon përfundimin e vitit të parë të studimeve në Master mund të ndikojë në besueshmërinë e CV-së dhe mund të ndikojë në vlerësimin e aftësive akademike të individit.</p> <p>Shkaku: Neglizhenca në mbajtjen e rregullt të dokumentacionit dhe administrimin e tij nga ana e Njësies Përgjegjëse.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i mesëm
Konkluzioni	<p>Duhet të rishikohet procedura e emërimit dhe të sigurohet që të gjitha procedurat të respektohen, duke përfshirë dokumentimin dhe miratimin e emërimit sipas rregulloreve të përcaktuara.</p> <p>Duhet të kërkohet dorëzimi i dëshmive të nevojshme për njohjen e gjuhës së huaj dhe të sigurohet që informacioni në CV të jetë i vërtetë dhe i përputhshëm me dokumentacionin.</p> <p>Duhet të sigurohet që të gjitha dokumentet që vërtetojnë arsimimin të jenë të plotë në dosjen e personelit, për të garantuar përputhshmërinë e informacionit dhe integritetin e procesit të vlerësimit të punonjësve.</p>
Rekomandimi	Të plotësohet dosja e personelit me dokumentacionin përkatës për emërimin në detyrë të Znj. Gerida Nure, me dëshminë e njohjes së gjuhës së huaj anglisht, me vërtetimin përkatës të përfundimit të vitit të parë të studimeve në Master i Shkencave në “Drejtim dhe menaxhim i mediave”.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë.
Statusi i rekomandimit	Është pranuar, nuk është paraqitur Observacion.

25. Titulli i Gjetjes: Mungojnë vlerësimet peridike për vitin 2024 për punonjësen Leonora Kalavace.

Nr. i Gjetjes 25	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR-LESKOVIK
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> Njësia Administrative Qendër-Leskovik; Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> Ligji Nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” (i ndryshuar).
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Inspektor tatim-taksash Znj. Leonora Kalavace është transferuar me Vendim Nr. 50 datë 11.09.2015 nga Njësia Përgjegjëse.</p> <p>2. Për vitin 2024, rezulton se nuk është bërë asnjë vlerësim i punës së kryer.</p> <p>Kriteri: Neni 62 i Ligjit Nr. 152/2013 “Për Nënpunësin Civil” (i ndryshuar).</p> <p>Ndikimi/Efekti: Transferimi i Znj. Leonora Kalavace dhe mungesa e vlerësimit të punës për vitin 2024 mund të ndikojë në performancën dhe motivimin e punonjëses, duke krijuar paqartësi lidhur me standardet dhe pritshmëritë për rezultatet e punës.</p> <p>Shkaku: Neglizhenca në përmbushjen e detyrave funksionale nga ana e Njesisë Përgjegjëse.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i mesëm
Konkluzioni	Duhet të bëhet një vlerësim i detajuar dhe i rregullt i punës së Znj. Leonora Kalavace dhe të punonjësve të tjerë, për të siguruar një sistem të drejtë dhe transparent të vlerësimit. Ky hap do të ndihmojë në përmirësimin e efikasitetit të punës dhe do të rrisë përgjegjshmërinë dhe motivimin e stafit.
Rekomandimi	Të merren masat për kryerjen e vlerësimit të punës sipas parashikimeve ligjore.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë.
Statusi i rekomandimit	Është pranuar, nuk është paraqitur Observacion.

26. Titulli i Gjetjes: Nuk është ngritur Komisioni për Nxjerrjen Jashtë Përdorimit të Aktiveve Publike të konstatuara si jashtë përdorimit nga Komisioni i Inventarizimit

Nr. i Gjetjes 26

Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR-LESKOVIK
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> Njësia Administrative Qendër-Leskovik; Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> Udhëzimi Nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” (i ndryshuar) i Ministrisë së Financave.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Nga inventarizimi i kryer në vitin 2023 me Urdhër Nr. 62, datë 25.01.2024 “Për ngritjen e komisioneve të vlerësimit të aktiveve”, komisionet kanë bërë vlerësimin e aktiveve për Njësinë Administrative Qendër-Leskovik, si në përmbledhësin më poshtë vijon.</p> <p>Kriteri: Udhëzimi Nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” (i ndryshuar) i Ministrisë së Financave.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mosngritja e Komisionit për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve publike të konstatuara si jashtë përdorimit nga Komisioni i inventarizimit mund të krijojë probleme me administrimin e pasurisë publike. Kjo mund të çojë në mbajtjen e pasurisë që nuk është më funksionale ose e dobishme, duke rritur kostot e mirëmbajtjes dhe duke penguar përdorimin efikas të burimeve publike.</p> <p>Shkaku: Mungesa e burimeve financiare dhe administrative dhe neglizhenca në kryerjen e deteyrave funksionale.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i lartë
Konkluzioni	Duhet të ngritet menjëherë Komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve publike, për të siguruar që pasuritë e identifikuar si të papërdorshme të hiqen nga inventari dhe të përpunohen në mënyrë të duhur. Ky hap do të ndihmojë në optimizimin e menaxhimit të pasurisë publike dhe do të kontribuojë në transparencën dhe efikasitetin e administratës publike.
Rekomandimi	Të ngrihet komision për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve publike të Njësisë Administrative Qendër-Leskovik, në zbatim të paragrafëve 107, 108 dhe 109 të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” (i ndryshuar) i Ministrisë së Financave.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Brenda 6-mujorit të parë të 2025.
Statusi i rekomandimit	Është pranuar, nuk është paraqitur Observacion.

		Gjendja	Furnizimi	Gjithsej	Pr.ver	Gjendja	
		31.12.2022				31.12.2023	Vërejtje
1.	Shkolla Pode	14792		14792			
2.	Zyra e Administratorit	57850		57850		57850	

3.	Zyra e Llogarise	29150			29150			29150
	SHUMA	101792	0		101792	0		101792

Tab. 1 Njësia Administrative Qendër-Leskovic (Llogaria 327)

		Gjendja	Furnizimi	Gjithësej	Pr.Ver	Gjendja
		31.12.2022				
1.	Shkolla Pode	74760		74760		74760
2.	Zyra e Kryetarit	285280		285280		285280
3.	Zyra e llogarisë	298760		298760		298760
4.	Ndriçues fshatrash	303000		303000		303000
	Shuma	961800		961800		961800

Tab.2 Njësia Administrative Qendër-Leskovic (Llogaria 214)

		Gjendja	Furnizimi	Gjithësej	Pr.ver	Gjendja	Vërejtje
		31.12.2022					
1.	Zyra e Administratorit	136320		136320		136320	
	Shuma	136320	0 0 0	136320	0 0 0	136320	0

Tab.2 Njësia Administrative Qendër-Leskovic (Llogaria 218)

40. **Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:** Planifikimi dhe menaxhimi i burimeve: Në lidhje me kapacitetet njerëzore, është evidentuar se disa dosje personeli nuk janë të plota, duke përfshirë mungesën e jetëshkrimeve dhe dokumentacionit të nevojshëm për disa pozita. Gjithashtu, mungojnë vlerësimet e punës për disa punonjës, si dhe procedurat për konfirmimin e statusit të nënpunësve civilë. Këto mangësi janë shkelje të parashikimeve ligjore, dhe është rekomanduar që të ndërmerren masa për plotësimin e dosjeve dhe për realizimin e vlerësimeve të punës, që do të përmirësonin menaxhimin dhe transparencën e burimeve njerëzore.

Në lidhje me infrastrukturën dhe inventarin, vlerësimi i aktiveve për vitin 2023 është kryer, por rekomandohet që të ngrihet një komision për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve të plota, në

përputhje me udhëzimet dhe rregullat për menaxhimin e aktiveve publike. Ky hap është i nevojshëm për të siguruar efikasitetin e përdorimit të burimeve dhe për të shmangur mbajtjen e aktiveve që nuk janë në përdorim, duke optimizuar kështu menaxhimin e pasurive publike.

Në lidhje me fondet e kufizuara, Njësia Administrative nuk ka përfituar fonde direkte, por ka marrë fonde të alokuara nga Drejtoria e Ekonomisë, Financës dhe Buxhetit. Kjo mund të nënkuptojë një menaxhim të qëndrueshëm të fondeve, por gjithashtu kërkon një vlerësim të hollësishëm të nevojave dhe shpërndarjes së fondeve për të siguruar një përdorim efikas të burimeve financiare.

41. 4.7 SISTEMI I KRIJIMIT DHE IMPLEMENTIMIT TË SISTEMVE

27. Titulli i Gjetjes: Nuk janë dixhitalizuar proceset e punës dhe ofrimit të shërbimeve.

Nr. i Gjetjes 27	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR-LESKOVIK
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> Njësia Administrative Qendër-Leskovik; Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar); Ligji Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar).
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Proceset e punës dhe ofrimit të shërbimeve nuk janë dixhitalizuar për shkak të mungesës së infrastructures.</p> <p>Kriteri: Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar); Ligji Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar).</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mungesa e dixhitalizimit për shkak të infrastrukturës së pamjaftueshme shkakton vonesa, rritje të kostove dhe mungesë transparence në ofrimin e shërbimeve publike. Kjo situatë pengon koordinimin institucional dhe e bën më të vështirë qasjen e qytetarëve në shërbime efikase dhe të automatizuara.</p> <p>Shkaku: Kapacitetet e kufizuara administrative dhe financiare.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i mesëm.
Konkluzioni	Mungesa e dixhitalizimit për shkak të infrastrukturës së pamjaftueshme ndikon negativisht në efikasitetin, transparencën dhe qasjen e qytetarëve ndaj shërbimeve publike. Për të përmirësuar këtë situatë, nevojiten investime në teknologji, trajnime për stafin dhe krijimi i një platforme të unifikuar dixhitale.
Rekomandimi	Të merren masa që në momentin e azhurnimit të infrastrukturës për dixhitalizimin e shërbimeve në Bashki, të merren në konsideratë edhe nevojat e Njesisë Administrative.

Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Është pranuar, nuk është paraqitur Observacion.

42. **Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:** Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, rezulton se bashkëpunimi ndërmjet Njësive Administrative dhe njësive të tjera, përfshirë Bashkinë, është i pranishëm dhe funksionon në mënyrë të kënaqshme. Njësitë si Drejtoria e Shërbimit Social dhe Njësia e Auditit të Brendshëm janë të integruara në proceset e përbashkëta. Ky bashkëpunim është esencial për koordinimin e aktiviteteve dhe mbështetjen e njëri-tjetrit në realizimin e detyrave. Megjithatë, do të ishte e dobishme të thellohej dhe optimizohej ky bashkëpunim, duke përfshirë më shumë trajnime dhe mundësi për shkëmbim të informacionit përmes platformave dixhitale.

Një nga sfidat më të mëdha është mungesa e dixhitalizimit të shërbimeve për shkak të infrastrukturës të pamjaftueshme. Proceset e punës dhe ofrimi i shërbimeve ende janë manuale dhe të centralizuara, gjë që kufizon efikasitetin dhe shpejtësinë e realizimit të shërbimeve për qytetarët. Ky problem mund të zgjidhet duke investuar në zhvillimin dhe përmirësimin e infrastrukturës dixhitale për të mundësuar automatizimin e procedurave dhe përdorimin e sistemeve të integruara. Rekomandimi është që kur të bëhen përmirësime të infrastrukturës, të merren parasysh nevojat e Njësive Administrative për dixhitalizim, për të siguruar që proceset të jenë më efikase dhe të lehta për përdoruesit. Ky hap do të ndihmojë në uljen e ngarkesës administrative dhe do të lehtësojë ofrimin e shërbimeve për qytetarët.

Në përgjithësi, sistemi ka hapësira për përmirësim në drejtim të dixhitalizimit dhe bashkëpunimit ndërmjet Njësive, por po punohet për t'i adresuar këto mangësi në të ardhmen.

43. **4.8 SISTEMI I PERPUTHSHMERISË ME RREGULLORET DHE PROCEDURAT**

Njësia Administrative funksionon në përputhje me parashikimet e bëra në nenin 66 të Ligjit Nr. 114/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar), i cili parashikon si detyra të Njesisë Administrative:

- a) është zyrë e shërbimit për të gjitha procedurat administrative në kompetencën e bashkisë;
- b) mbikëqyr territorin për zbatimin e ligjit në të gjitha fushat në kompetencën e bashkisë dhe njofton strukturat kompetente të bashkisë në rast të konstatimit të veprimeve në kundërshtim me ligjin;
- c) mbështet punën e strukturave kompetente të bashkisë;
- ç) bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë, mund të administrojë parqet, lulishtet dhe zonat e gjelbëruara;

- d) bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë, mund të administrojë tregjet publike;
- dh) bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë, mund të administrojë këndet e lojërave, terrenet sportive, bibliotekat, shtëpitë dhe klubet e rinisë;
- e) përgatit dhe i propozon kryetarit të bashkisë planin për investimet nën juridiksionin e saj territorial, si dhe mbikëqyr, pas miratimit, zbatimin e tyre, sipas ligjit;
- ë) propozon, sipas ligjit, emërtimin e rrugëve, shesheve, institucioneve dhe objekteve që janë nën juridiksionin e saj territorial;
- f) mbështet, koordinon dhe mbikëqyr veprimtarinë e kryetarëve e të kryesive të fshatrave;
- g) i propozon kryetarit të bashkisë dhënien e titujve të nderit dhe stimujve për personat nën juridiksionin e saj territorial;
- gj) propozon marrjen e nismave në dobi të komunitetit me mundësi të barabarta dhe përfitime nga të gjithë brenda juridiksionit të saj territorial;
- h) kryen çdo funksion tjetër të deleguar nga kryetari i bashkisë.

28. Titulli i Gjetjes: Njësia nuk ka respektuar asnjë nga parashikimet e nenit 66 të Ligjit Nr. 114/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar).

Nr. i Gjetjes 28	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR-LESKOVIK
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> Njësia Administrative Qendër-Leskovik; Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar).
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se Njësia nuk ka respektuar parashikimet e pikave “b”, “ç”, “d”, “e”, “ë”, “f”, “g” dhe “gj” nenit 66 të Ligjit Nr. 114/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar).</p> <p>Kriteri: Neni 66 të Ligjit Nr. 114/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar).</p> <p>Ndikimi/Efekti: Ky mosrespektim mund të çojë në shkelje procedurale, ulje të efikasitetit dhe humbje besimi nga qytetarët dhe institucionet mbikëqyrëse.</p> <p>Shkaku: Mosnjohja e parashikimeve ligjore.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i lartë
Konkluzioni	Mospërmbushja e detyrimeve të nenit 66 të Ligjit Nr. 114/2015 nga Njësia dëmton transparencën, llogaridhënien dhe funksionimin e saj ligjor. Për të shmangur pasojat negative, është e nevojshme që Njësia të zbatojë detyrimet ligjore dhe të marrë masa korrigjuese për përmirësimin e qeverisjes vendore.

Rekomandimi	Të merren masa për plotësimin e detyrave ligjore dhe dokumentimin e punës së kryer në bazë dhe në zbatim të ligjit.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Është pranuar, nuk është paraqitur Observacion.

29. Titulli i Gjetjes: Përdorimi i pajisjeve elektorinike për të vendosur datën e dokumentit të nxjerrë.

Nr. i Gjetjes 29	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR-LESKOVIK
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Njësia Administrative Qendër-Leskovik; • Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Manuali i Trajnimit Për Punonjësit e Zyrës së Arkivit dhe Protokollit të Njësive të Qeverisjes Vendore.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Në Manualin e Trajnimit Për Punonjësit e Zyrës së Arkivit dhe Protokollit të Njësive të Qeverisjes Vendore , parashikohet se “<i>data dhe numri i protokollit vendoset gjithmonë pas firmosjes nga titullari</i>”. Përsa mësipër, në aktet e nxjerra nga Njësia Administrative, data e plotë është vendosur me pajisje elektronike dhe më pas është nënshkruar dokumenti nga Administratori.</p> <p>Kriteri: Manuali i Trajnimit Për Punonjësit e Zyrës së Arkivit dhe Protokollit të Njësive të Qeverisjes Vendore.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Përdorimi i pajisjeve elektronike për vendosjen e datës dhe numrit të protokollit para firmosjes nga titullari bie në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në Manualin e Trajnimit, i cili specifikon që këto të dhëna duhet të vendosen pas firmosjes. Kjo mund të ndikojë në ligjshmërinë e dokumenteve dhe mund të shkaktojë paqartësi ose vështirësi në verifikimin e procesit të protokollimit.</p> <p>Shkaku: Neglizhenca në kryerjen e detyrave funksionale.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i mesëm.

Konkluzioni	Duhet të rishikohet dhe modifikohet praktika e përdorur, duke siguruar që data dhe numri i protokollit të vendosen vetëm pas firmosjes nga titullari, në përputhje me Manualin e Trajnimit. Ky ndryshim do të sigurojë përputhshmërinë me procedurat e përcaktuara dhe do të rrisë saktësinë dhe transparencën në protokollimin e dokumenteve.
Rekomandimi	Të merren masa për zbatimin e Manualit të Trajnimit Për Punonjësit e Zyrës së Arkivit dhe Protokollit të Njësive të Qeverisjes Vendore për të respektuar kërkesat ligjore mbi formatin e shkresave zyrtare.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Është pranuar, nuk është paraqitur Observacion.

30. Titulli i Gjetjes: Për disa akte ka mosrakordim mes datës së dokumentit dhe datës me të cilën dokumenti është regjistruar në Rregjistrin e Korrespondencës (Protokollit).

Nr. i Gjetjes 30	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR-LESKOVIK
Njësitet/ subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Njësia Administrative Qendër-Leskovik; • Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji Nr. 1954/2003 “Për Arkivat” <i>(i ndryshuar)</i>; • Manual Trajnimi Për Punonjësit e Zyrës së Arkivit dhe Protokollit të Njësive të Qeverisjes Vendore.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Për aktet siç tregohet në tabelën më poshtë ka mosrakordim mes datës së dokumentit dhe datës me të cilën dokumenti është regjistruar në Rregjistrin e Korrespondencës (Protokollit).</p> <p>Kriteri: Ligji Nr. 1954/2003 “Për Arkivat” <i>(i ndryshuar)</i> Manual Trajnimi Për Punonjësit e Zyrës së Arkivit dhe Protokollit të Njësive të Qeverisjes Vendore</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mosrakordimi midis datës së dokumentit dhe datës së regjistrimit në Rregjistrin e Korrespondencës krijon pasiguri në procesin e administratës dhe mund të shkaktojë probleme në gjurmimin dhe verifikimin e dokumenteve. Kjo mund të ndikojë negativisht në proceset ligjore dhe mund të krijojë konfuzion në lidhje me renditjen dhe afatet e dokumenteve.</p> <p>Shkaku: Neglizhenca në plotësimin e Regjistrit të Korrespondencës (Protokollit)</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i lartë.

Konkluzioni	Duhet të realizohet një verifikim i hollësishëm i të gjitha akteve të regjistruara, duke siguruar që data e dokumentit dhe data e regjistrimit të përputhen. Ky hap është thelbësor për të garantuar saktësinë dhe përputhshmërinë në regjistrimin e dokumenteve dhe për të parandaluar problemet administrative dhe ligjore në të ardhmen.
Rekomandimi	Të saktësohet data e aktit nga ana e Njesisë Administrative
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë.
Statusi i rekomandimit	Është pranuar, nuk është paraqitur Observacion.

Nr.	DOKUMENTI	DATA E DOKUMENTIT	DATA NË REGJISTËR
1.	Vërtetim Nr.425 (43)	02.04.2024	03.04.2024
2.	Dërgim konfirmimi për studentët Nr.426(44)	02.04.2024	03.04.2024
3.	Kontratë Qiraje Nr.94	28.03.2024	Nr. 93 Prot., datë 06.06.2024
4.	Kontratë Qiraje Nr.95	28.03.2024	06.06.2024
5.	Njoftim Nr.105	16.07.2024	10.07.2024
6.	Njoftim Nr.106	16.07.2024	10.07.2024
7.	Vërtetim Nr.109	26.07.2024	29.07.2024
8.	Kërkesë Nr.136	12.09.2024	13.09.2024
9.	Vërtetim Nr.143	18.09.2024	19.09.2024

31. Titulli i Gjetjes: Mungojnë fizikisht një pjesë e akteve të regjistruara në Rregjistrin e Korrespondencës (Protokollit).

Nr. i Gjetjes 31	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR-LESKOVIK
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> Njësia Administrative Qendër-Leskovik; Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> Ligji Nr. 1954/2003 “Për Arkivat” (i ndryshuar); Manual Trajnimi Për Punonjësit e Zyrës së Arkivit dhe Protokollit të Njësive të Qeverisjes Vendore.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Një pjesë e akteve, sipas tabelës së mëposhtme janë regjistruar në Rregjistrin e Korrespondencës (Protokollit), por nuk bëjnë pjesë në dokumentacionin e dorëzuar pranë NJAB-së.</p> <p>Kriteri: Ligji Nr. 1954/2003 “Për Arkivat” (i ndryshuar). Manual Trajnimi Për Punonjësit e Zyrës së Arkivit dhe Protokollit të Njësive të Qeverisjes Vendore.</p>

	<p>Ndikimi/Efekti: Pjesa e akteve që janë regjistruar në Regjistrin e Korrespondencës, por nuk janë dorëzuar pranë NJAB-së, mund të krijojë mangësi në dokumentacionin e dorëzuar dhe të dëmtojë proceset e kontrollit dhe auditimit. Kjo mund të sjellë probleme me verifikimin dhe gjurmimin e dokumenteve dhe mund të shkaktojë pasiguri ligjore dhe administrative.</p> <p>Shkaku: Neglizhenca në plotësimin dhe dorëzimin e dokumentacionit.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i lartë.
Konkluzioni	Duhet të bëhet një rishikim i menjëhershëm për të siguruar që të gjitha aktet e regjistruara në Regjistrin e Korrespondencës të dorëzohen gjithashtu në NJAB, për të garantuar transparencën dhe saktësinë në dokumentacionin e administratës.
Rekomandimi	Të vihen në dispozicion të NJAB-së aktet e padorëzuara.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë.
Statusi i rekomandimit	Është pranuar, nuk është paraqitur Observacion.

Nr.	AKTI
1.	Shkresa Nr.428 Prot., datë 04.04.2024
2.	Shkresa Nr.409 Prot., datë 04.04.2024
3.	Shkresa Nr.410 Prot., datë 04.04.2024
4.	Shkresa Nr.411 Prot., datë 04.04.2024
5.	Shkresa Nr.412 Prot., datë 04.04.2024
6.	Shkresa Nr.413 Prot., datë 04.04.2024
7.	Shkresa Nr.414 Prot., datë 04.04.2024
8.	Shkresa Nr.55 Prot., datë 23.04.2024
9.	Kontratë Qiraje Nr. 67 Prot., datë 26.04.2024
10.	Kontratë Qiraje Nr. 68 Prot., datë 26.04.2024
11.	Kontratë Qiraje Nr. 69 Prot., datë 26.04.2024
12.	Kontratë Qiraje Nr. 70 Prot., datë 26.04.2024
13.	Kontratë Qiraje Nr. 71 Prot., datë 26.04.2024
14.	Kontratë Qiraje Nr. 72 Prot., datë 26.04.2024
15.	Kontratë Qiraje Nr. 73 Prot., datë 29.04.2024
16.	Kontratë Qiraje Nr. 74 Prot., datë 29.04.2024
17.	Kontratë Qiraje Nr. 75 Prot., datë 29.04.2024
18.	Kontratë Qiraje Nr. 78 Prot., datë 30.04.2024
19.	Kontratë Qiraje Nr. 79 Prot., datë 30.04.2024
20.	Kontratë Qiraje Nr. 80 Prot., datë 30.04.2024
21.	Kontratë Qiraje Nr. 82 Prot., datë 03.05.2024

22.	Akti Nr.83 Prot., datë 03.05.2024
23.	Kontratë Qiraje Nr. 90 Prot., datë 23.05.2024
24.	Proces-verbal Nr.91 Prot., datë 03.06.2024
25.	Kontratë Qiraje Nr. 92 Prot., datë 06.06.2024
26.	Kontratë Qiraje Nr. 93 Prot., datë 06.06.2024
27.	Kërkesë Nr.99 prot., datë 10.06.2024
28.	Proces-Verbal Nr.100 Prot., datë 11.06.2024
29.	Njoftim Nr.101 Prot., datë 11.06.2024
30.	Akt Nr.137 Prot., datë 13.09.2024
31.	Proces-Verbal Nr.148 Prot., datë 23.09.2024
32.	Proces-Verbal Nr.149 Prot., datë 25.09.2024
33.	Proces-Verbal Nr.154 Prot., datë 26.09.2024
24.	Proces-Verbal Nr.155 Prot., datë 27.09.2024
35.	Afishim publik Nr.157 Prot., datë 30.09.2024
36.	Akt Nr.161/I Prot., datë 14.10.2024
37.	Akt Nr.168 Prot., datë 22.10.2024
38.	Akt Nr.169 Prot., datë 22.10.2024

32. Titulli i Gjetjes: Janë konstatuar parregullësi dhe pasaktësi në mbajtjen e numrave të protokollit për aktet e nxjerra.

Nr. i Gjetjes 32	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR-LESKOVIK
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Njësia Administrative Qendër-Leskovik; • Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji Nr. 1954/2003 “Për Arkivat” <i>(i ndryshuar)</i>; • Manual Trajnimi Për Punonjësit e Zyrës së Arkivit dhe Protokollit të Njësive të Qeverisjes Vendore.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Numerimi i ri në Regjistrin e Korrespondencës nuk ka filluar me numër rendor të ri 01 (në datën 01.01.2024) , por ka vijuar me numrat rendorë të vitit 2023, përkatësisht me numrin 383 dhe ky rend ka vijuar deri në aktin me numër protokollir 49, datë 11.04. 2024, duke bërë që aktet nga data 03.01.2024 deri më 08.04.2024 të kenë 2 numra protokollit. Nga akti me Nr. 430 (48) Prot., datë 08.04.2024 është kaluar në Aktin me Nr. 49 Prot., datë 11.04 2024, i cili duhet të ishte numri rendor i radhës nëse numërimi do të kishte filluar me numër 01 Prot., në fillim të vitit.</p> <p>Kriteri: Ligji Nr. 1954/2003 “Për Arkivat” <i>(i ndryshuar)</i>; Manual Trajnimi Për Punonjësit e Zyrës së Arkivit dhe Protokollit të Njësive të Qeverisjes Vendore.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Ky problem ka krijuar konfuzion dhe ka ndikuar në organizimin e dokumenteve, pasi aktet nga 03.01.2024 deri më 08.04.2024 kanë dy numra protokollit, gjë që mund të sjellë pasiguri në identifikimin dhe gjurmimin e dokumenteve.</p>

	Shkaku: Neglizhenca në kryerjen e detyrave funksionale.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i lartë.
Konkluzioni	Për të shmangur dublimin e numrave dhe konfuzionin, duhet të fillohet me numrin 1 në vitin 2024 dhe të rregullohet sistemi i numërimit i cili është shtyrë nga viti 2023, duke siguruar vijueshmëri dhe korrektësi në protokollimin e dokumenteve.
Rekomandimi	Të mbahet saktë numri i protokollit duke filluar nga dita e parë e punës për vitin korent, duke filluar me numër protokollit 01 dhe jo vazhdim numerik i vitit paraardhës.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Është pranuar, nuk është paraqitur Observacion.

33. Titulli i Gjetjes: Dokumentacioni nuk është hartuar dhe nuk është mbajtur në formën e kërkuar nga ligji.

Nr. i Gjetjes 33	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR-LESKOVIK
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Njësia Administrative Qendër-Leskovik; • Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji Nr. 1954/2003 “Për Arkivat” (i ndryshuar); • Manual Trajnimi Për Punonjësit e Zyrës së Arkivit dhe Protokollit të Njësive të Qeverisjes Vendore.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: 1. Shkresa Nr.358 Prot., datë 16.02.2024 e ardhur nga Drejtoria Vendore e Policisë Korçë, protokolluar nga Bashkia Kolonjë me Nr. 930 Prot., datë 20.02.2024 i sigluar për Administratorin nga Sekretari i Përgjithshëm i mungon numri i protokollit nga Njësia Administrative.</p> <p>2. Shkresa Nr.652/14 Prot., datë 10.09.2024 e ardhur nga Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Elbasan i mungon numri i protokollit nga Njësia Administrative.</p> <p>3. Akti Nr.184 është regjistruar në Regjistër, por i mungon numri rendor shkresës së ardhur.</p> <p>4. Nr. 174 i protokollit për dokumentin me datë 12.11.2024, rezulton i përdorur në dy vërtetime të ndryshme. Njëri prej tyre duhet të kishte numrin e protokollit 175.</p> <p>5. Aktit Nr.178 Prot, datë 14.11.2024 nuk i është shënuar shkurtimi i lëndës në Regjistrin e Korrespondencës.</p>

	<p>6. Vërtetim Nr.358 (03) Prot., datë 04.01.2024 dhe Vërtetimit Nr.420 Prot., datë18.03.2024 i mungon vula si element thelbësor formal.</p> <p>7. Shkresa Nr. 124 Prot., datë 27.08.2024, është shkresë për kthim përgjigje dhe nuk ka marrë Numrin e Protokollimit të shkresës së ardhur, po ashtu mungon nënshkrimi i administratorit dhe vula, si elemente formalë thelbësorë.</p> <p>8. Shkresa Nr. 125 Prot., datë 27.08.2024, është shkresë për kthim përgjigje dhe nuk ka marrë Numrin e Protokollimit të shkresës së ardhur.</p> <p>9. Disa Proces-Verbale janë të pajisur me Vulën e Bashkisë dhe elementët formalë, ndërsa të tjerëve ju mungojnë sipas tabelës më poshtë.</p> <p>Kriteri: Ligji Nr. 1954/2003 “Për Arkivat” (i ndryshuar). Manual Trajnimi Për Punonjësit e Zyrës së Arkivit dhe Protokollit të Njësive të Qeverisjes Vendore</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mungesa e informacionit të plotë në dokumentacionin e mësipërm, si numri i protokollit, vula, dhe nënshkrimi i administratorit, ka një ndikim negativ në proceset administrative dhe ligjore. Kjo mund të çojë në vonesa në procedura, pasiguri në regjistrimin e dokumenteve, dhe mund të ndikojë në vlefshmërinë e dokumenteve, duke krijuar mundësi për keqinterpretim ose gabime në menaxhimin e korrespondencës. Po ashtu, përdorimi i një numri të njëjtë protokollit në dy vërtetime të ndryshme mund të shkaktojë konfuzion dhe të dëmtojë besueshmërinë e procedurave administrative.</p> <p>Shkaku: Mungesa e njohurive teknike dhe të përgjithshme ligjore dhe neglizhenca në ushtrimin e detyrave funksionale.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i lartë.
Konkluzioni	Për të parandaluar probleme të mëtejshme dhe për të siguruar një menaxhim të saktë dhe të rregullt të dokumenteve, duhet të ndërmerren hapa për përmirësimin e sistemit të protokollimit dhe regjistrimit të dokumenteve. Njësitet përkatëse duhet të sigurojnë që çdo dokument të përmbushë kërkesat formale, duke përfshirë numrin e protokollit, nënshkrimin e administratorit dhe vulën. Përdorimi i numrave të ndryshëm të protokollit për çdo dokument dhe shënimi i plotë i informacionit në Regjistër është thelbësor për të siguruar një menaxhim efikas dhe të qartë të korrespondencës administrative.
Rekomandimi	Të merren masa për mbajtjen e dokumentacionit dhe hartimin e tij në formën e kërkuar nga ligji.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Është pranuar, nuk është paraqitur Observacion.

Nr.	Proces-Verbal
1.	Proces-Verbal Nr.396 Prot., datë 15.01.2024

2.	Proces-Verbal Nr. 01 Prot., datë 22.01.2024
3.	Proces-Verbal Nr. 02 Prot., datë 23.01.2024
4.	Proces-Verbal Nr. --- Prot., datë 16.04.2024 (Proces-Verbali nuk ka numër)
5.	Proces-Verbal Nr. --- Prot., datë 29.04.2024 (Proces-Verbali nuk ka numër)
6.	Proces-Verbal Nr. ---Prot., datë 30.04.2024 (Proces-Verbali nuk ka numër)
7.	Proces-Verbal Nr. ---Prot., datë 06.06.2024 (Proces-Verbali nuk ka numër)
8.	Proces-Verbal Nr. ---Prot., datë 19.08.2024 (Proces-Verbali nuk ka numër)
9.	Proces-Verbal Nr. ---Prot., datë 22.08.2024 (Proces-Verbali nuk ka numër)
10.	Proces-Verbal Nr. ---Prot., datë 26.08.2024 (Proces-Verbali nuk ka numër)
11.	Proces-Verbal Nr. ---Prot., datë 27.08.2024 (Proces-Verbali nuk ka numër)
12.	Proces-Verbal Nr. ---Prot., datë 28.08.2024 (Proces-Verbali nuk ka numër)
13.	Proces-Verbal Nr. ---Prot., datë 29.08.2024 (Proces-Verbali nuk ka numër)
14.	Proces-Verbal Nr. ---Prot., datë 06.09.2024 (Proces-Verbali nuk ka numër)
15.	Proces-Verbal Nr. ---Prot., datë 09.09. 2024 (Proces-Verbali nuk ka numër)
16.	Proces-Verbal Nr. ---Prot., datë 10.09. 2024 (Proces-Verbali nuk ka numër)
17.	Proces-Verbal Nr.--- Prot., datë 11.09.2024 (Proces-Verbali nuk ka numër)
18.	Proces-Verbal Nr.--- Prot., datë 19.09.2024 (Proces-Verbali nuk ka numër)
19.	Proces-Verbal Nr. ---Prot., datë 14.10.2024 (Proces-Verbali nuk ka numër)
20.	Proces-Verbal Nr. ---Prot., datë 15.10.2024 (Proces-Verbali nuk ka numër)
21.	Proces-Verbal Nr.--- Prot., datë 16.10.2024 (Proces-Verbali nuk ka numër)
22.	Proces-Verbal Nr.--- Prot., datë 17.10.2024 (Proces-Verbali nuk ka numër)
23.	Proces-Verbal Nr.--- Prot., datë 18.10.2024 (Proces-Verbali nuk ka numër)
24.	Proces-Verbal Nr.--- Prot., datë 21.10.2024 (Proces-Verbali nuk ka numër)
25.	Proces-Verbal Nr.--- Prot., datë 22.10.2024 (Proces-Verbali nuk ka numër)

34. Titulli i Gjetjes: Mungojnë raportet periodike mbi veprimtarinë e Njesisë Administrative për vitin 2024.

Nr. i Gjetjes 34	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR-LESKOVIK
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> Njësia Administrative Qendër-Leskovik; Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” <i>(i ndryshuar)</i>.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se Njësia nuk ka raportuar periodikisht mbi veprimtarinë e kryer prej saj gjatë vitit 2024.</p> <p>Kriteri: Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” <i>(i ndryshuar)</i>.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mungesa e raporteve periodike mund të çojë në pasiguri dhe të ngadalësojë përmirësimin e proceseve, mund të krijojë vështirësi në vlerësimin e progresit të veprimtarive të njësisë dhe mund të ndikojë negativisht në marrëdhëniet me palët e interesuara.</p> <p>Shkaku: Neglizhenca në kryerjen e detyrave funksionale.</p>

Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i mesëm.
Konkluzioni	Njësia duhet të sigurojë që të përmbushë kërkesat për raportim të rregullt dhe të sigurojë një mekanizëm të besueshëm dhe të organizuar për monitorimin dhe raportimin e aktiviteteve të saj. Përndryshe, kjo mund të ndikojë negativisht në performancën e saj dhe të rrisë riskun e sanksioneve ose vlerësimeve negative.
Rekomandimi	Të merren masa për raportim periodik çdo 6 muaj mbi veprimtarinë e Njesisë.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Është pranuar, nuk është paraqitur Observacion.

35. Titulli i Gjetjes: Nuk janë adresuar problematikat dhe boshllëqet që janë hasur në zbatimin e detyrave ligjore.

Nr. i Gjetjes 35	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR-LESKOVIK
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Njësia Administrative Qendër-Leskovik • Bashkia Kolonjë
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (<i>i ndryshuar</i>) • Ligji Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (<i>i ndryshuar</i>)
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se Njësia nuk ka marrë asnjë masë për adresimin e problematikave dhe boshllëqeve që janë hasur në zbatimin e detyrave ligjore.</p> <p>Kriteri: Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (<i>i ndryshuar</i>), Ligji Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (<i>i ndryshuar</i>)</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mungesa e kërkesave nga qytetarët ose kryepletqë e zonës për plotësimin e nevojave dhe shërbimeve bazike tregon një mangësi në komunikimin dhe angazhimin me komunitetin. Kjo mund të çojë në pasiguri lidhur me nevojat reale të qytetarëve dhe të mos ofrojë shërbime të nevojshme dhe të personalizuara. Gjithashtu, mungesa e kërkesave mund të jetë një shenjë e mungesës së besimit në institucionin përkatës ose një sinjal që qytetarët nuk janë të informuar apo nuk dinë si të shprehin nevojat e tyre për shërbime.</p> <p>Shkaku: Neglizhenca në kryerjen e detyrave funksionale.</p>

Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i mesëm
Konkluzioni	Për të adresuar këtë problem, Njësia Administrative duhet të ndërmarrë hapa për të rritur komunikimin dhe përfshirjen e qytetarëve, duke krijuar mundësi më të qarta dhe të aksesueshme për dorëzimin e kërkesave dhe shprehjen e nevojave të tyre. Kjo mund të realizohet përmes organizimit të takimeve të rregullta me qytetarët, përdorimit të kanaleve të komunikimit të teknologjisë së informacionit dhe krijimit të mundësive të thjeshta për të paraqitur kërkesat. Kjo do të ndihmojë në ofrimin e shërbimeve më të personalizuara dhe do të përmirësojë marrëdhënien ndërmjet qytetarëve dhe administratës.
Rekomandimi	Të merren masa për adresimin e problematikave dhe boshllëqeve të hasura si dhe të mbahet dokumentacion shoqërues
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi
Statusi i rekomandimit	Është pranuar, nuk është paraqitur Observacion.

44. **Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:** Nga analiza e të dhënave të ofruara për raportin e auditimit, rezulton se Njësia Administrative e Qendrës-Leskovik ka disa shkelje të rregullave dhe procedurave të parashikuara nga Ligji Nr. 114/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", që kërkojnë vëmendje dhe masa të menjëhershme për përmirësim. Në veçanti, ka mungesa në përmbushjen e disa detyrave të përcaktuara nga ligji, si mbikëqyrja e territorit, mbështetje e strukturave të bashkisë, dhe propozohet që këto detyra të plotësohen dhe dokumentohen me saktësi.

Në lidhje me dokumentimin dhe raportimin, janë identifikuar disa mangësi, si mosrespektimi i procedurave për protokollimin e akteve, numërimi i gabuar i protokolleve dhe mungesa e numrave të protokollit për disa akte të rëndësishme. Ky pasivitet në organizimin e dokumenteve mund të ndikojë në ligjshmërinë e procesëve administrative dhe të krijojë probleme në transparencën dhe kontrollin e aktiviteteve.

45. **4.9 SISTEMI I SHËRBIMEVE DHE NDIKIMIT MBI QYTETARET**

36. Titulli i Gjetjes: Mungojnë kërkesat e qytetarëve apo kryepleqve të zonës për plotësimin e nevojave apo shërbimeve bazike.

Nr. i Gjetjes 36	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR-LESKOVIK

Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Njësia Administrative Qendër-Leskovik • Bashkia Kolonjë
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” <i>(i ndryshuar)</i>
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se ka mungesë të kërkesave të qytetarëve apo kryepleqve të zonës për plotësimin e nevojave apo shërbimeve bazike.</p> <p>Kriteri: Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” <i>(i ndryshuar)</i>.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mungesa e kërkesave nga qytetarët ose kryepleqtë e zonës për plotësimin e nevojave dhe shërbimeve bazike tregon një mangësi në komunikimin dhe angazhimin me komunitetin. Kjo mund të çojë në pasiguri lidhur me nevojat reale të qytetarëve dhe të mos ofrojë shërbime të nevojshme dhe të personalizuara. Gjithashtu, mungesa e kërkesave mund të jetë një shenjë e mungesës së besimit në institucionin përkatës ose një sinjal që qytetarët nuk janë të informuar apo nuk dinë si të shprehin nevojat e tyre për shërbime.</p> <p>Shkaku: Neglizhenca në kryerjen e detyrave funksionale.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i mesëm.
Konkluzioni	Për të adresuar këtë problem, Njësia Administrative duhet të ndërmarrë hapa për të rritur komunikimin dhe përfshirjen e qytetarëve, duke krijuar mundësi më të qarta dhe të aksesueshme për dorëzimin e kërkesave dhe shprehjen e nevojave të tyre. Kjo mund të realizohet përmes organizimit të takimeve të rregullta me qytetarët, përdorimit të kanaleve të komunikimit të teknologjisë së informacionit dhe krijimit të mundësive të thjeshta për të paraqitur kërkesat. Kjo do të ndihmojë në ofrimin e shërbimeve më të personalizuara dhe do të përmirësojë marrëdhënien ndërmjet qytetarëve dhe administratës.
Rekomandimi	Të mbahet dokumentacioni i rregullt dhe të pasqyrojë kërkesat e qytetarëve dhe kryepleqve.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Është pranuar, nuk është paraqitur Observacion.

46. **Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:** Është e qartë se mungesa e kërkesave nga qytetarët dhe kryepleqtë për shërbime bazike në Njësinë Administrative Qendër-Leskovik është një çështje që kërkon vëmendje të menjëhershme. Kjo mungesë kërkesash mund të tregojë një mangësi të rëndësishme në lidhjen dhe komunikimin mes administratës dhe komunitetit, që është thelbësor për funksionimin efikas të vetëqeverisjes vendore. Kjo situatë ka ndikim të drejtpërdrejtë në mënyrën se si shërbimet ofrohen dhe menaxhohen, pasi mungesa e kërkesave

mund të çojë në nevojën për shërbime që nuk janë të personalizuar dhe të përshtatura për nevojat e qytetarëve. Gjithashtu, mund të nënkuptojë një mungesë besimi në administratën lokale, që mund të ndihmojë në zvogëlimin e angazhimit të qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

47. 4.10 SISTEMI I RISKUT DHE SIFADAT PER FUNKSIONIM

37. Titulli i Gjetjes: Mungon dokumentacioni mbi veprimtarinë e Gjendjes Civile, Arkës si pjesë e sistemit të financave dhe shërbimeve publike.

Nr. i Gjetjes 37	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR-LESKOVIK
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Njësia Administrative Qendër-Leskovik; • Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” <i>(i ndryshuar)</i>.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Momentalisht Njësia ofron shërbime të fokusuar në nxjerrjen e vërtetimeve për efekt dokumentacioni për banorët, lidhjen e kontrtave, publikimin e akteve dhe njoftimin publik të tyre, ofrimin e shërbimit të taksave dhe tarifave vendore dhe të gjendjes civile, megjithatë vetëm për sistemin e taksave dhe tarifave vendore janë vënë në dispozicion vetëm vërtetimet e shlyerjes së detyrimeve.</p> <p>Kriteri: Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” <i>(i ndryshuar)</i>.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Shërbimet e ofruara nga Njësia Administrative janë kryesisht të orientuara drejt vërtetimeve dhe administrimit bazik të dokumentacionit, pa një sistem të plotë dhe të integruar për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore. Kjo kufizon mundësinë e monitorimit efektiv të të ardhurave vendore, duke ndikuar negativisht në transparencën financiare dhe mbledhjen e të ardhurave publike. Mungesa e një sistemi të plotë për administrimin e taksave mund të çojë në evazion fiskal, vonesa në arkëtim dhe ulje të kapacitetit të njësisë për të ofruar shërbime publike cilësore për qytetarët.</p> <p>Shkaku: Neglizhenca në përmbushjen e detyrave funksionale.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i lartë.
Konkluzioni	Njësia Administrative duhet të ndërmarrë masa për të përmirësuar menaxhimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore duke zbatuar një platformë më të strukturuar dhe transparente. Kjo do të ndihmonte në rritjen e të ardhurave vendore, përmirësimin e shërbimeve publike dhe forcimin e llogaridhënies financiare. Përmirësimi i sistemit të administrimit fiskal do të garantonte një menaxhim më efikas dhe të drejtë të detyrimeve financiare të qytetarëve.

Rekomandimi	Të merren masa për dorëzimin e dokumentacionit të munguar.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Është pranuar, nuk është paraqitur Observacion.

38. Titulli i Gjetjes: Mungon Regjistri i Riskut të Njesisë Administrative.

Nr. i Gjetjes 38	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR-LESKOVIK
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Njësia Administrative Qendër-Leskovik; • Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (<i>i ndryshuar</i>); • Manualin e Menaxhmit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër Nr. 108, datë 17.11.2016 të Ministrit të Financave.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Nuk është hartuar Regjistri i Riskut për Njësinë Administrative Qendër-Leskovik, në shkelje të nenit 21 të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (<i>i ndryshuar</i>), parashikimeve të bëra në Manualin e Menaxhmit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër Nr. 108, datë 17.11.2016 të Ministrit të Financave, si dhe duke mos përmbushur Rekomandimet e lëna nga Raporti Përfundimtar Nr. 186/19 Prot., datë 25.07.2024 i Kontrollit të Lartë të Shtetit.</p> <p>Kriteri: Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (<i>i ndryshuar</i>); Manualin e Menaxhmit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër Nr. 108, datë 17.11.2016 të Ministrit të Financave.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mungesa e Regjistrimit të Riskut për Njësinë Administrative Barmash-Novoselë përbën një shkelje të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi, duke ndikuar negativisht në menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Kjo situatë rrit ekspozimin ndaj risqeve financiare dhe operationale, ul transparencën dhe llogaridhënien në administrimin e fondeve publike dhe mund të sjellë pasoja në efektivitetin dhe efikasitetin e shërbimeve publike. Gjithashtu, moszbatimi i rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit reflekton dobësi në përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe mund të çojë në masa ndëshkuese apo kufizime buxhetore në të ardhmen.</p> <p>Shkaku: Neglizhenca në përmbushjen e detyrave funksionale.</p>

Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i lartë.
Konkluzioni	Mos hartimi i Regjistrit të Riskut përbën një mangësi serioze në sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm të Njesisë Administrative, duke shkelur ligjin dhe udhëzimet përkatëse. Për të adresuar këtë problem, është e domosdoshme marrja e masave të menjëhershme për përgatitjen dhe implementimin e këtij regjistri, si dhe për zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Përmirësimi i procesit të menaxhimit të riskut do të ndihmojë në rritjen e transparencës, forcimin e kontrollit të brendshëm dhe përmirësimin e performancës financiare të njesisë administrative.
Rekomandimi	Të merren masa për hartimin e Regjistrit të Riskut dhe rishikimin e tij 2 (dy) herë në vit.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Çdo 6 muaj brenda vitit 2025.
Statusi i rekomandimit	Është pranuar, nuk është paraqitur Observacion.

48. *Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit: Sistemi i ofrimit të shërbimeve për qytetarët në Njësinë Administrative Qendër-Leskovik ka disa mangësi që ndikojnë negativisht në përmbushjen e nevojave të qytetarëve. Në veçanti, mungesa e kërkesave të qytetarëve dhe kryepelqve për shërbimet bazike tregon një lëshim në regjistrimin dhe dokumentimin e nevojave të komunitetit, gjë që mund të çojë në mungesën e përmirësimit të shërbimeve. Mungesa e dokumentacionit të duhur dhe raportimi i kërkesave është një problem që duhet adresuar me urgjencë, duke i dhënë mundësi administratës të mbajë një lidhje të drejtpërdrejtë dhe transparente me qytetarët.*

Përsa i përket shërbimeve aktuale, të ofruara nga Njësia, si nxjerrja e vërtetimeve dhe taksat vendore, është e qartë se ka një nevojë për një ndërhyrje më të thellë për të përmirësuar sistemin dhe për të ofruar dokumentacion të plotë për shërbimet, duke përfshirë edhe vërtetimet e shlyerjes së detyrimeve. Kjo është një mundësi e mirë për të përmirësuar efikasitetin dhe besueshmërinë e administratës lokale.

Në lidhje me menaxhimin e riskut, mungesa e hartimit të Regjistrit të Riskut është një shkelje serioze që ndikon në menaxhimin e përgjithshëm të njesisë. Kjo mangësi, në bashkëpunim me dështimin për të zbatuar rekomandimet nga raporti i Kontrollit të Lartë të Shtetit, tregon një nivel të ulët të transparencës dhe kontrollit mbi risqet që mund të ndikojnë në funksionimin e njesisë. Për të adresuar këtë, është e nevojshme që të hartohet një Regjistër i Riskut dhe të

rishikohet rregullisht, duke siguruar një menaxhim të rreptë dhe të monitoruar të financave dhe procedurave të brendshme.

49. 4.11 SISTEMI I PLANIFIKIMIT DHE MENAXHIMIT TË BURIMEVE

39. Titulli i Gjetjes: Mungesë dokumentacioni në dosjen e personelit të Administratorit Z. Spiro Zoto.

Nr. i Gjetjes 39	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR-ERSEKË
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Njësia Administrative Qendër-Ersekë; • Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.2995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); • Ligjit Nr.139/2025 “Për vetëqeverisjen vendore”.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: 1. Administratori është i emëruar me Urdhër të Kryetarit Nr. 368, datë 07.07.2023, sipas parashikimeve të pikës “ë” të nenit 64, të Ligjit Nr.139/2025 “Për vetëqeverisjen vendore”;</p> <p>2. Certifikata personale mungon në dosjen e personelit për efekt provueshmërie, gjë kjo që vjen në kundërshtim me parashikimet e pikës 2 të nenit 65 të Ligjit Nr.139/2025 “Për vetëqeverisjen vendore”.</p> <p>3. Jetëshkrimi mungon në dosjen e personelit.</p> <p>4. Mungon Kontrata Individuale e Punës. nenit 21 të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.2995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar).</p> <p>Kriteri: Neni 21 të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.2995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar);</p> <p>Pika 2 të nenit 65 të Ligjit Nr.139/2025 “Për vetëqeverisjen vendore”.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mungesa e dokumenteve të nevojshme, si certifikata personale, jetëshkrimi dhe kontrata individuale e punës, dëmton besueshmërinë dhe transparencën e procesit të punës dhe administratës. Kjo mund të krijojë hapësirë për keqadministrim dhe shkelje ligjore, duke i ulur besimin në sistem dhe duke rritur rrezikun e mosmarrëveshjeve ligjore.</p> <p>Shkaku: Neglizhenca nga ana e Njësië Përgjegjëse në mbledhjen dhe administrimin e dokumentacionit të personelit.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i mesëm.

Konkluzioni	Mungesa e këtyre dokumenteve të nevojshme krijon një hapësirë për keqadministrim dhe mund të dëmtojë besueshmërinë e sistemit administrativ. Për të siguruar që njësia administrative të funksionojë në përputhje me ligjin dhe të ruajë integritetin dhe transparencën e saj, duhet të merret menjëherë masa për plotësimin e këtyre mangësive dhe për ndjekjen e procedurave të duhura për dokumentimin dhe kontratat e punës.
Rekomandimi	Të plotësohet dosja me Certifikatën Personale për Administratorin, me jetëshkrimin dhe me Kontratën Individuale.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë.
Statusi i rekomandimit	Është pranuar, nuk është paraqitur Observacion.

40. Titulli i Gjetjes: Mungesë dokumentacioni në dosjen e personelit të Znj. Fjoralda Iljazi

Nr. i Gjetjes 40	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR-ERSEKË
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Njësia Administrative Qendër-Ersekë; • Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja për Pranimin në Detyrë të Punonjësit të Gjendjes Civile miratuar me Urdhërin Nr.1366 Prot., datë 19.08.2006 i Ministrit të Brendshëm.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: 1. Punonjësi i Gjendjes civile është i emëruar me Urdhër Nr. 73, datë 06.05.2016, por procedura e emërimit mungon, në kundërshtim me parashikimet e bëra nga Rregullorja për Pranimin në Detyrë të Punonjësit të Gjendjes Civile miratuar me Urdhërin Nr.1366 Prot., datë 19.08.2006 i Ministrit të Brendshëm.</p> <p>2. Jetëshkrimi mungon në dosjen e personelit.</p> <p>Kriteri: Rregullorja për Pranimin në Detyrë të Punonjësit të Gjendjes Civile miratuar me Urdhërin Nr.1366 Prot., datë 19.08.2006 i Ministrit të Brendshëm; Pika 2 të nenit 65 të Ligjit Nr.139/2025 “Për vetëqeverisjen vendore”.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Në rastin e parë, duket se ka një mospërputhje mes aktit të emërimit të punonjësit të gjendjes civile dhe procedurës së parashikuar nga Rregullorja për Pranimin në Detyrë të Punonjësit të Gjendjes Civile. Sipas Urdhrit Nr. 1366 Prot., datë 19.08.2006 të Ministrit të Brendshëm, duhet të ekzistojë një procedurë e qartë për emërimin e punonjësve të gjendjes civile, e cila nuk është zbatuar në këtë rast. Ky gabim mund të çojë në pasiguri ligjore dhe mund të shfaqë rreziqe për përshtatshmërinë e punonjësit në detyrën e tij, si dhe mund të shkaktojë pasoja në menaxhimin e duhur të procedurave të gjendjes civile. Në rastin e dytë, mungesa e jetëshkrimit në dosjen e personelit është një tjetër shkelje e mundshme e rregullave dhe procedurave të përshkruara për menaxhimin e dosjeve të punonjësve. Jetëshkrimi është një dokument i rëndësishëm që siguron informacion të detajuar mbi kualifikimet dhe përvojën e punonjësit, dhe mungesa</p>

	e tij mund të ndikojë në vlerësimin e aftësive dhe kualifikimeve të individit për pozitën që mbulon. Kjo mund të sjellë pasiguri në proceset e rekrutimit, promovimit dhe vlerësimit të performancës. Shkaku: Neglizhenca nga ana e Njësië Përgjegjëse në mbledhjen dhe administrimin e dokumentacionit të personelit.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i mesëm.
Konkluzioni	Në përfundim, këto shkelje mund të ndikojnë në integritetin e procesit të punësimit dhe menaxhimit të punonjësve të gjendjes civile. Mungesa e një procedure të saktë emërimi dhe e jetëshkrimit në dosjen e personelit mund të krijojë probleme të ligjshme dhe organizative, duke cënuar transparencën dhe rendin në punën e administratës publike. Rekomandohet që të bëhen përmirësime në respektimin e rregulloreve përkatëse dhe të sigurohet që dosjet e punonjësve të jenë të plota dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Rekomandimi	Të merren masat për plotësimin e dosjes së personelit me dokumentacionin përkatës për emërimin në detyrë të Znj. Fjoralda Iljazi dhe jetëshkrimit.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë.
Statusi i rekomandimit	Është pranuar, nuk është paraqitur Observacion.

41. Titulli i Gjetjes: Nuk është ngritur Komisioni për Nxjerrjen Jashtë Përdorimit të Aktiveve Publike të konstatuara si jashtë përdorimit nga Komisioni i Inventarizimit.

Nr. i Gjetjes 41	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR-ERSEKË
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> Njësia Administrative Qendër-Ersekë; Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> Udhëzimi Nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” (<i>i ndryshuar</i>) i Ministrisë së Financave.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Nga inventarizimi i kryer në vitin 2023 me Urdhër Nr. 62, datë 25.01.2024 “Për ngritjen e komisioneve të vlerësimit të aktiveve”, komisionet kanë bërë vlerësimin e aktiveve për Njësinë Administrative Qendër-Leskovik, si në përmbledhësin më poshtë vijon.</p> <p>Kriteri: Udhëzimi Nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” (<i>i ndryshuar</i>) i Ministrisë së Financave.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mosngritja e Komisionit për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve publike të konstatuara si jashtë përdorimit nga Komisioni i inventarizimit</p>

	mund të krijojë probleme me administrimin e pasurisë publike. Kjo mund të çojë në mbajtjen e pasurisë që nuk është më funksionale ose e dobishme, duke rritur kostot e mirëmbajtjes dhe duke penguar përdorimin efikas të burimeve publike. Shkaku: Mungesa e burimeve financiare dhe administrative dhe neglizhenca në kryerjen e detyrave funksionale.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i lartë.
Konkluzioni	Duhet të ngritet menjëherë Komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve publike, për të siguruar që pasuritë e identifikuar si të papërdorshme të hiqen nga inventari dhe të përpunohen në mënyrë të duhur. Ky hap do të ndihmojë në optimizimin e menaxhimit të pasurisë publike dhe do të kontribuojë në transparencën dhe efikasitetin e administratës publike.
Rekomandimi	Të ngrihet komision për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve publike të Njësisë Administrative Qendër-Ersekë, në zbatim të paragrafëve 107, 108 dhe 109 të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” (i ndryshuar) i Ministrisë së Financave.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Brenda 6-mujorit të parë të 2025.
Statusi i rekomandimit	Është pranuar, nuk është paraqitur Observacion.

Nr	Nr. Inventarit / nomenklaturës	Emërtimi	Njësia	Çmimi	Sipas të dhënave kontabël		Sipas të dhënave të inventarizimit		Rezultatet				Arsyej jashtë përdorimi
					sasia	vlefë	sasia	vlefë	Mungesat		Tepricat		
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
16	32	Mbajtëse kancelari e	cope	396	1	396	1	396					Amortizuar
17	32	Mbajtëse dokumetash	cope	660	1	660	1	660					Amortizuar
18	32	USB 8GB	cope	511.7	1	512	1	512					Amortizuar
19	32	Fikësezja rri	cope	5136	2	10,272	2	10,272					Amortizuar
20	32	Flamurko mbëtar atlas	cope	180	1	180	1	180					Amortizuar
		SHUMA				12,020		12,020					

Tab. 1 Njësia Administrative Qendër-Ersekë

50. **Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:** Projekt-Raporti i auditimit identifikon disa mangësi në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturës në Njësinë Administrative Qendër-Ersekë. Mungesa e dokumenteve si certifikata personale, jetëshkrimi dhe kontrata individuale për administratorin janë shkelje të ligjit dhe kërkojnë plotësimin e menjëhershëm të dosjeve të personelit. Po ashtu, punonjësi i gjendjes civile nuk ka 60dministr e emërimin të plotë.

Sa i përket infrastrukturës, inventarizimi tregon se asetet janë të amortizuara dhe kërkojnë azhurnim. Rekomandohet përmirësimi i menaxhimit të dokumenteve dhe inventarit, dhe zbatimi i këtyre rekomandimeve është i domosdoshëm për të rritur efikasitetin dhe transparencën e 60dministrates.

Nga takimi fillestar i mbajtur me administratorët, sikurse del nga Proces-Verbal Nr. 56, protokolluar më datë 25.11.2024, Z. Spiro Zoto, Administrator i Njësisë Administrative Qendër-Ersekë, pavarësisht se është njoftuar në mënyrë të rregullt me shkresën Nr. 5465 Prot., datë 20.11.2024, nuk është paraqitur në takim. Me shkresën Nr. 5645 Prot., datë 03.12.2024 është njoftuar rregullisht për vënien në dispozicion të Njësisë së Auditit të Brendshëm të dokumentacionit të kërkuar, me qëllim zhvillimin e rregullt të angazhim auditimit. Është njoftuar përsëri me mjetet e komunikimit elektronik nga Njësia e Auditit të Brendshëm dhe nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar.

Edhe pas shterimit të të gjithë mjeteve të komunikimit, përsëri dokumentacioni i kërkuar nuk është dorëzuar. Po aq për këtë fakt është njoftuar edhe Titullari me Memo Nr. 297 Prot., datë 17.01.2025.

Në mënyrë të përsëritur ka refuzuar të marrë shkresat e NJAB-së për informacion apo dokumentacion.

Në këto kushte, puna audituese, në përmbushje të detyrimeve ligjore, është bërë e pamundur.

Në gjykimin e Njësisë së Auditit të Brendshëm, neglizhenca ndaj angazhim-auditimit, mosbindja e urdhërit të Titullarit të Institucionit, mosdorëzimi i dokumentacionit të kërkuar nga NJAB me porosi të Titullarit, përbën shkelje të rëndë të detyrimit të kujdesit në punë sipas nenit 24 të Kodit të Punës, prandaj kërkojmë nga Titullari i Institucionit të marrë në konsideratë largimin nga detyra të Administratorit, për shkaqe të arsyetura të lidhura me neglizhencën e vazhduar në përmbushjen e detyrave funksionale.

51. 4.12 SISTEMI I PLANIFIKIMIT DHE MENAXHIMIT TË BURIMEVE

42. **Titulli i Gjetjes:** Mungesë dokumentacioni në dosjen e personelit të Administratorit Z. Xhentil Avdyli.

Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE MOLLAS-ÇLIRIM
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Njësia Administrative Mollas-Çlirim; • Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.2995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); • Ligjit Nr.139/2025 “Për vetëqeverisjen vendore”.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: 1. I emëruar me Urdhër të Kryetarit Nr. 49, datë 01.02.2023, sipas parashikimeve të pikës “ë” të nenit 64, të Ligjit Nr.139/2025 “Për vetëqeverisjen vendore”.</p> <p>2. Plotëson kriteret e pikës 2 të nenit 65 të Ligjit Nr.139/2025 “Për vetëqeverisjen vendore”, ka vendbanimin në Kolonjë sikurse del nga Certifikata personale e datës 23.12.2020.</p> <p>3. Është konfirmuar si nëpunës civil me aktin Nr. 5740 Prot., datë 02.12.2022. Në dosjen e personelit mungon kërkesa për pezullimin e statusit të nëpunësit, duke qenë se përbën konflikt me detyrën aktuale e cila rregullohet sipas Kodit të Punës.</p> <p>4. Mungon Kontrata Individuale e Punës, në kundërshtim me parashikimet e nenit 21 të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.2995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar).</p> <p>5. Për vitin 2024, rezulton se nuk është bërë asnjë vlerësim i punës së kryer duke shkelur parashikimet e bëra nga neni 62 i Ligjit Nr. 152/2013 “Për Nënpunësin Civil” (i ndryshuar).</p> <p>Kriteri: Neni 21 të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.2995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar);</p> <p>Pika 2 të nenit 65 të Ligjit Nr.139/2025 “Për vetëqeverisjen vendore”.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mungesa e vlerësimit të punës është një shkelje e neneve të Ligjit për Nënpunësin Civil, dhe do të ndikojë në motivimin e punonjësit dhe mundësitë e tij për zhvillim profesional. Vlerësimi i punës është një instrument i rëndësishëm për përmirësimin e performancës dhe mundësitë e karrierës.</p> <p>Shkaku: Neglizhenca nga ana e Njësië Përgjegjëse në mbledhjen dhe administrimin e dokumentacionit të personelit.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i mesëm.
Konkluzioni	Duhet të realizohet një vlerësim i detajuar i punës së kryer për vitin 2024 për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe për të mbajtur një administratë të motivuar dhe efikase.
Rekomandimi	Të plotësohet dosja me Kërkesën për pezullimin e Statusit të Nënpunësit dhe Kontratën Individuale për Administratorin dhe të merren masat për kryerjen e vlerësimit të punës sipas parashikimeve ligjore.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë.

Statusi i rekomandimit	Është pranuar, nuk është paraqitur Observacion.
-------------------------------	---

43. Titulli i Gjetjes: Mungesë dokumentacioni në dosjen e personelit të punonjësit të Gjendjes Civile Znj. Eliona Dalipi.

Nr. i Gjetjes 43	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE MOLLAS-ÇLIRIM
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Njësia Administrative Mollas-Çlirim; • Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja për Pranimin në Detyrë të Punonjësit të Gjendjes Civile miratuar me Urdhërin Nr.1366 Prot., datë 19.08.2006 i Ministrit të Brendshëm.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: 1. Punonjësi i Gjendjes Civile është i emëruar me Urdhër Nr. 67, datë 06.05.2016, por procedura e emërimit mungon, në kundërshtim me parashikimet e bëra nga Rregullorja për Pranimin në Detyrë të Punonjësit të Gjendjes Civile miratuar me Urdhërin Nr.1366 Prot., datë 19.08.2006 i Ministrit të Brendshëm.</p> <p>2. Jetëshkrimi nuk plotëson standardet dhe kërkesat e formatit Europass.</p> <p>Kriteri: Rregullorja për Pranimin në Detyrë të Punonjësit të Gjendjes Civile miratuar me Urdhërin Nr.1366 Prot., datë 19.08.2006 i Ministrit të Brendshëm”.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mungesa e plotësimit të jetëshkrimit sipas standardeve të Europass mund të ndikojë negativisht në transparencën dhe profesionalizmin e dosjes së punonjësit. Përdorimi i një formati të miratuar mund të lehtësojë procesin e vlerësimit dhe mund të rrisë besueshmërinë përpara institucioneve dhe palëve të treta.</p> <p>Shkaku: Neglizhenca nga ana e Njësië Përgjegjëse në mbledhjen dhe administrimin e dokumentacionit të personelit.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i mesëm.
Konkluzioni	Rekomandohet që jetëshkrimi të plotësohet në përputhje me standardet Europass për të siguruar një dosje të rregullt dhe të standardizuar, që është e lehtë për tu verifikuar dhe e pranueshme për çdo procedurë të mundshme.
Rekomandimi	Të merren masat për plotësimin e dosjes së personelit me dokumentacionin përkatës për emërimin në detyrë të Znj. Eliona Dalipi dhe të merren masat për dorëzimin e Jetëshkrimit sipas standardit Europass.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë.

Statusi i rekomandimit	Është pranuar, nuk është paraqitur Observacion.
-------------------------------	---

44. Titulli i Gjetjes: Nuk është ngritur Komisioni për Nxjerrjen Jashtë Përdorimit të Aktiveve Publike të konstatuara si jashtë përdorimit nga Komisioni i Inventarizimit

Nr. i Gjetjes 44	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE MOLLAS-ÇLIRIM
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> Njësia Administrative Mollas-Çlirim; Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> Udhëzimi Nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” (<i>i ndryshuar</i>) i Ministrisë së Financave.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Nga inventarizimi i kryer në vitin 2023 me Urdhër Nr. 62, datë 25.01.2024 “Për ngritjen e komisioneve të vlerësimit të aktiveve”, komisionet kanë bërë vlerësimin e aktiveve për Njësinë Administrative Mollas-Çlirim, si në përmbledhësin më poshtë vijon.</p> <p>Kriteri: Udhëzimi Nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” (<i>i ndryshuar</i>) i Ministrisë së Financave.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mosngritja e Komisionit për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve publike të konstatuara si jashtë përdorimit nga Komisioni i inventarizimit mund të krijojë probleme me administrimin e pasurisë publike. Kjo mund të çojë në mbajtjen e pasurisë që nuk është më funksionale ose e dobishme, duke rritur kostot e mirëmbajtjes dhe duke penguar përdorimin efikas të burimeve publike.</p> <p>Shkaku: Mungesa e burimeve financiare dhe administrative dhe neglizhenca në kryerjen e deteyrave funksionale.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i lartë.
Konkluzioni	Duhet të ngritet menjëherë Komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve publike, për të siguruar që pasuritë e identifikuar si të papërdorshme të hiqen nga inventari dhe të përpunohen në mënyrë të duhur. Ky hap do të ndihmojë në optimizimin e menaxhimit të pasurisë publike dhe do të kontribuojë në transparencën dhe efikasitetin e administratës publike.
Rekomandimi	Të ngrihet komision për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve publike të Njësisë Administrative Qendër-Ersekë, në zbatim të paragrafëve 107, 108 dhe 109 të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” (<i>i ndryshuar</i>) i Ministrisë së Financave.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Brenda 6-mujorit të parë të 2025.

Statusi i rekomandimit	Është pranuar, nuk është paraqitur Observacion.
-------------------------------	---

Nr.	Emërtimi	LLOGARITË		LLOGARITË		TOTALI
		311	332	214	218	
1.	Shkolla Luaras 9-vjeçar				155288	155288
2.	M.P. Dorëzuar Magazine	16570	21000			37570
3.	Materiale Salle e Mbledhjeve				67400	67400
4.	Hidraulike				18000	18000
5.	Zyra e Përkrahjes/ sociale		250			250
6.	Materiale Zyra e Kadastrës				1000	1000
7.	Zyra e Arshivës				23800	23800
8.	Shkolla 9 vjeçare Çlirim		16000	0	82010	98010
9.	Qendra Shëndetësore Çlirim		25000		18000	43000
10.	Zyra e Administratorit		1450		142760	144210
11.	Zyra e Sekretarit		2600	0	254650	257250
12.	Zyra e financës		25600		20905	46505
	SHUMA	16570	91900	0	783813	892283

Tab. 1 Njësia Administrative Çlirim(Llogaria 327)

Nr.	Nr i Inventarit/ nomenklaturës	EMËRTIMI	Njësia	Çmimi	Sipas të dhënave kontabël		Sipas të dhënave të inventarizimit		REZULTATET				Vërejtje
					sasia	vlef	sasia	vlef	Mungesat		Tepricat		
									sasia	vlef	sasia	vlef	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
1	“	Portmonto Pasqyre		1800	1	1800	1	1800					
2	“	Byfe		20000	1	20000	1	20000					
3	“	Kompjuter		158000	1	158000	1	158000					
4	“	Tavolinë		9120	1	9120	1	9120					
5	“	Rusten Wielen		3204	1	3204	1	3204					
6	“	Tavolne e rrumbullakët		8000	1	8000	1	8000					
7	“	Tavoline zyre		15000	1	15000	1	15000					
8	“	Printer		42900	1	42900	1	42900					
9	“	Bateri UPS		22100	1	22100	1	22100					
10	“	Abazhur		5000	2	10000	2	10000					
11		Kompjuter		70311	1	70311.	1	70311					

		Think Centre		.6		6		.6					
12		Printer LexMark		14726.4	1	14726.4	1	14726.4					
13		UPS power		7580.4	1	7580.4	1	7580.4					
		SHUMA I				382742.4		382742.4					
1	327	Pjate duhani		150	1	150	1	150					
2		Falmur tresh		1000	1	1000	1	1000					
3		Tyl	ml	400	3	1200	3	1200					
4		Shine	ml	250	3	750	3	750					
5		Zgjatues kabulli	cope	900	1	900	1	900					
6		Aparat telefonik		3000	1	3000	1	3000					
7		Por zjarri		16000	1	16000	1	16000					
8		Vazo lule		500	1	500	1	500					
9		Kosh plehrash		500	1	500	1	500					
10		Foto e Presidentit		1500	1	1500	1	1500					
11		Kornize foto		1500	1	1500	1	1500					
12		Qyngje +brryla kafe		549.5	2	1099	2	1099					
13		Korniza I. Qemali		1850	1	1850	1	1850					
14		Gershere		120	2	240	2	240					
15		Makine llogaritese		800	2	1600	2	1600					
16		Kyc vares		180	5	900	5	900					
17		Mbajtese mjetesh		725	1	725	1	725					
18		Farashke		132	1	132	1	132					
19		Fshese merimange		180	1	180	1	180					
20		Falmur atlas		540	2	1080	2	1080					
21		Farashke plehrash		84	1	84	1	84					
22		Flamur kombetar atlas		720	5	3600	5	3600					
23		Farashke		60	1	60	1	60					
24		Krevat portativ te		4198.8	20	83976	20	83976					

		kthyeshem											
25		Cadra arabe te kthyeshme	28000	3	84000	3	84000						
26		USB 8GB	512	1	512	1	512						
27		Fikese zjarri	5236	1	5236	1	5236						
28		Farashke plehrash	120	1	120	1	120						
		SHUMA II			212294		212294						
		SHUMA I+II			595036		595036						

Tab.2 Njësia Administrative Zyra e Administratorit

52. **Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:** Raporti auditimi tregon se ka disa mangësi në menaxhimin e burimeve dhe infrastrukturës në njësinë administrative Mollas-Çlirim. Mungesat në dokumentacionin e personelit dhe dallimet në inventar kërkojnë veprime urgjente për të përmirësuar funksionimin dhe transparencën e sistemit. Të gjitha rekomandimet duhet të implementohen në kohë për të siguruar përputhshmërinë me ligjin dhe për të optimizuar menaxhimin e burimeve.

53. 4.13 SISTEMI I KRIJIMIT DHE IMPLEMENTIMIT TË SISTEMVE

45. **Titulli i Gjetjes:** Nuk janë dixhitalizuar proceset e punës dhe ofrimit të shërbimeve.

Nr. i Gjetjes 45	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE MOLLAS-ÇLIRIM
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> Njësia Administrative Mollas-Çlirim; Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar); Ligji Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar).
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Proceset e punës dhe ofrimit të shërbimeve nuk janë dixhitalizuar për shkak të mungesës së infrastructures.</p> <p>Kriteri: Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar); Ligji Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar).</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mungesa e dixhitalizimit për shkak të infrastrukturës së pamjaftueshme shkakton vonesa, rritje të kostove dhe mungesë transparence në ofrimin e shërbimeve publike. Kjo situatë pengon koordinimin institucional dhe e bën më të vështirë qasjen e qytetarëve në shërbime efikase dhe të automatizuara.</p> <p>Shkaku: Kapacitetet e kufizuara administrative dhe financiare.</p>

Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i mesëm.
Konkluzioni	Mungesa e dixhitalizimit për shkak të infrastrukturës së pamjaftueshme ndikon negativisht në efikasitetin, transparencën dhe qasjen e qytetarëve ndaj shërbimeve publike. Për të përmirësuar këtë situatë, nevojiten investime në teknologji, trajnime për stafin dhe krijimi i një platforme të unifikuar dixhitale.
Rekomandimi	Të merren masa që në momentin e azhurnimit të infrastrukturës për dixhitalizimin e shërbimeve në Bashki, të merren në konsideratë edhe nevojat e Njësive Administrative.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Është pranuar, nuk është paraqitur Observacion.

54. *Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit: Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, rezulton se bashkëpunimi ndërmjet Njësive Administrative dhe njësive të tjera, përfshirë Bashkinë, është i pranishëm dhe funksionon në mënyrë të kënaqshme. Njësitë si Drejtoria e Shërbimit Social dhe Njësia e Auditit të Brendshëm janë të integruara në proceset e përbashkëta. Ky bashkëpunim është esencial për koordinimin e aktiviteteve dhe mbështetjen e njëri-tjetrit në realizimin e detyrave. Megjithatë, do të ishte e dobishme të thellohej dhe optimizohej ky bashkëpunim, duke përfshirë më shumë trajnime dhe mundësi për shkëmbim të informacionit përmes platformave digjitale.*

Një nga sfidat më të mëdha është mungesa e dixhitalizimit të shërbimeve për shkak të infrastrukturës të pamjaftueshme. Proceset e punës dhe ofrimi i shërbimeve ende janë manuale dhe të centralizuara, gjë që kufizon efikasitetin dhe shpejtësinë e realizimit të shërbimeve për qytetarët. Ky problem mund të zgjidhet duke investuar në zhvillimin dhe përmirësimin e infrastrukturës dixhitale për të mundësuar automatizimin e procedurave dhe përdorimin e sistemeve të integruara. Rekomandimi është që kur të bëhen përmirësime të infrastrukturës, të merren parasysh nevojat e Njësive Administrative për dixhitalizim, për të siguruar që proceset të jenë më efikase dhe të lehta për përdoruesit. Ky hap do të ndihmojë në uljen e ngarkesës administrative dhe do të lehtësojë ofrimin e shërbimeve për qytetarët.

Në përgjithësi, sistemi ka hapësira për përmirësim në drejtim të dixhitalizimit dhe bashkëpunimit ndërmjet Njësive, por po punohet për t'i adresuar këto mangësi në të ardhmen.

55. **4.14 SISTEMI I PERPUTHSHMERISË ME RREGULLORET DHE PROCEDURAT**

Njësia Administrative funksionon në përputhje me parashikimet e bëra në nenin 66 të Ligjit Nr. 114/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar), i cili parashikon si detyra të Njesisë Administrative:

- a) është zyrë e shërbimit për të gjitha procedurat administrative në kompetencën e bashkisë;
- b) mbikëqyr territorin për zbatimin e ligjit në të gjitha fushat në kompetencën e bashkisë dhe njofton strukturat kompetente të bashkisë në rast të konstatimit të veprimeve në kundërshtim me ligjin;
- c) mbështet punën e strukturave kompetente të bashkisë;
- ç) bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë, mund të administrojë parqet, lulishtet dhe zonat e gjelbëruara;
- d) bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë, mund të administrojë tregjet publike;
- dh) bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë, mund të administrojë këndet e lojërave, terrenet sportive, bibliotekat, shtëpitë dhe klubet e rinisë;
- e) përgatit dhe i propozon kryetarit të bashkisë planin për investimet nën juridiksionin e saj territorial, si dhe mbikëqyr, pas miratimit, zbatimin e tyre, sipas ligjit;
- ë) propozon, sipas ligjit, emërtimin e rrugëve, shesheve, institucioneve dhe objekteve që janë nën juridiksionin e saj territorial;
- f) mbështet, koordinon dhe mbikëqyr veprimtarinë e kryetarëve e të kryesive të fshatrave;
- g) i propozon kryetarit të bashkisë dhënien e titujve të nderit dhe stimujve për personat nën juridiksionin e saj territorial;
- gj) propozon marrjen e nismave në dobi të komunitetit me mundësi të barabarta dhe përfitime nga të gjithë brenda juridiksionit të saj territorial;
- h) kryen çdo funksion tjetër të deleguar nga kryetari i bashkisë.

Njësia ka respektuar të gjitha parashikimet e nenit 66 të Ligjit Nr. 114/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar) me aq sa del nga dokumentacioni i dorëzuar.

46. Titulli i Gjetjes: Përdorimi i pajisjeve elektorinike për të vendosur datën e dokumentit të nxjerrë.

Nr. i Gjetjes 46	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE MOLLAS-ÇLIRIM
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Njësia Administrative Mollas-Çlirim; • Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Manuali i Trajnimit Për Punonjësit e Zyrës së Arkivit dhe Protokollit të Njësive të Qeverisjes Vendore.
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Në Manualin e Trajnimit Për Punonjësit e Zyrës së Arkivit dhe Protokollit të Njësive të Qeverisjes Vendore , parashikohet se “ <i>data dhe numri i</i>

	<p><i>protokollit vendoset gjithmonë pas firmosjes nga titullari</i>". Përsa mësipër, në aktet e nxjerra nga Njësia Administrative, data e plotë është vendosur me pajisje elektronike dhe më pas është nënshkruar dokumenti nga Administratori.</p> <p>Kriteri: Manuali i Trajnimit Për Punonjësit e Zyrës së Arkivit dhe Protokollit të Njësive të Qeverisjes Vendore.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Përdorimi i pajisjeve elektronike për vendosjen e datës dhe numrit të protokollit para firmosjes nga titullari bie në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në Manualin e Trajnimit, i cili specifikon që këto të dhëna duhet të vendosen pas firmosjes. Kjo mund të ndikojë në ligjshmërinë e dokumenteve dhe mund të shkaktojë paqartësi ose vështirësi në verifikimin e procesit të protokollimit.</p> <p>Shkaku: Neglizhenca në kryerjen e detyrave funksionale.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i lartë.
Konkluzioni	Duhet të rishikohet dhe modifikohet praktika e përdorur, duke siguruar që data dhe numri i protokollit të vendosen vetëm pas firmosjes nga titullari, në përputhje me Manualin e Trajnimit. Ky ndryshim do të sigurojë përputhshmërinë me procedurat e përcaktuara dhe do të rrisë saktësinë dhe transparencën në protokollimin e dokumenteve.
Rekomandimi	Të merren masa për zbatimin e Manualit të Trajnimit Për Punonjësit e Zyrës së Arkivit dhe Protokollit të Njësive të Qeverisjes Vendore për të respektuar kërkesat ligjore mbi formatin e shkresave zyrtare.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Është pranuar, nuk është paraqitur Observacion.

47. Titulli i Gjetjes: Mungon vula e Institucionit si element formal thelbësor i dokumentave administrative në Proces-Verbale dhe Numri i Porcesverbalit.

Nr. i Gjetjes 47	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE MOLLAS-ÇLIRIM
Njësitet/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Njësia Administrative Mollas-Çlirim; • Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Manuali i Trajnimit Për Punonjësit e Zyrës së Arkivit dhe Protokollit të Njësive të Qeverisjes Vendore.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Mungon vula e institucionit si element thelbësor formal i Proces-Verbaleve, për Proces-Verbalet dhe numri i tyre, sipas tabelës së mëposhtme.</p> <p>Kriteri: Manuali i Trajnimit Për Punonjësit e Zyrës së Arkivit dhe Protokollit të</p>

	<p>Njësive të Qeverisjes Vendore.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mungesa e vulës së institucionit në Proces-Verbale është një shkelje e elementeve formale që rregullojnë dokumentimin zyrtar. Vula është një element kyç që verifikon autenticitetin e dokumentit dhe mund të ndikojë në vlefshmërinë ligjore të këtij akti. Kjo mund të krijojë dyshime mbi legalitetin e dokumenteve dhe mund të ndikojë negativisht në proceset administrative dhe kontrollin e ligjshmërisë.</p> <p>Shkaku: Neglizhenca në kryerjen e detyrave funksionale.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i lartë.
Konkluzioni	Mungesa e vulës mund të çojë në vështirësi juridike dhe administrative për verifikimin dhe miratimin e dokumenteve të tilla. Është e nevojshme që të merren masa për të siguruar që çdo Proces-Verbal të jetë i vulosur dhe të përmbushë kërkesat ligjore për të parandaluar pasojat negative dhe për të garantuar transparencën dhe besueshmërinë e dokumenteve të krijuara.
Rekomandimi	Të merren masa për hartimin e rregullt të Proces-Verbaleve.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Është pranuar, nuk është paraqitur Observacion.

48. Titulli i Gjetjes: Njësia nuk ka raportuar periodikisht mbi veprimtarinë e kryer prej saj gjatë vitit 2024.

Nr. i Gjetjes 48	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE MOLLAS-ÇLIRIM
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Njësia Administrative Mollas-Çlirim; • Bashkia Kolonjë.
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (<i>i ndryshuar</i>).
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Nga dokumentacioni i dorëzuar del se Njësia nuk ka raportuar periodikisht mbi veprimtarinë e kryer prej saj gjatë vitit 2024.</p> <p>Kriteri: Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (<i>i ndryshuar</i>).</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mungesa e raportimit periodik për veprimtarinë e Njesisë gjatë vitit 2024 kufizon transparencën dhe llogaridhënien institucionale, duke e bërë të vështirë monitorimin e performancës dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore. Kjo mund të çojë në mungesë kontrolli dhe vlerësimi të duhur mbi veprimtarinë e</p>

	institucionit, duke rritur rrezikun e keqadministrimit. Shkaku: Neglizhenca në kryerjen e detyrave funksionale.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i mesëm.
Konkluzioni	Mosraportimi periodik cenon transparencën dhe efektivitetin e qeverisjes vendore. Për të siguruar menaxhim të mirë dhe përputhshmëri me kërkesat ligjore, është e nevojshme vendosja e një praktike të rregullt raportimi dhe monitorimi të veprimtarisë së Njesisë.
Rekomandimi	Të merren masa për raportim periodik çdo 6 muaj mbi veprimtarinë e Njesisë.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi.
Statusi i rekomandimit	Është pranuar, nuk është paraqitur Observacion.

56. *Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit: Në bazë të analizës së dokumentacionit dhe verifikimeve të bëra, mund të konstatohet se Njësia Administrative ka përmbushur shumicën e detyrave dhe përgjegjësive që parashikohen në Ligjin Nr. 114/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", duke u mbështetur në rregulloret dhe procedurat përkatëse. Megjithatë, ka disa mangësi që duhet adresuar për të përmirësuar funksionimin dhe siguruar përputhshmërinë e plotë me rregullat e vendosura. Dokumentacioni është mbajtur në përputhje me kërkesat e Manualit të Trajnimit Për Punonjësit e Zyrës së Arkivit dhe Protokollit të Njësive të Qeverisjes Vendore, por ka pasur disa mangësi teknike si mungesa e plotësimin të datës dhe numrit të protokollit pas firmosjes. Kjo mund të ndikojë në besueshmërinë dhe mund të shkaktojë pasiguri në proceset administrative. Mungesa e vulës si element formal për Proces-Verbale ka qenë një tjetër çështje, duke e bërë vështirë të verifikoni vlefshmërinë ligjore të dokumenteve. Njësia gjithashtu ka dështuar të sigurojë raportim periodik mbi veprimtarinë e saj, një praktikë që është e rëndësishme për transparencën dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve administrative.*

57. 4.15 SISTEMI I RISKUT DHE SIFADAVE PËR FUNKSIONIMIN

49. **Titulli i Gjetjes:** Mungon Regjistri i Riskut të Njesisë Administrative.

Nr. i Gjetjes 49	
Subjekti i Audituar	NJËSIA ADMINISTRATIVE MOLLAS-ÇLIRIM
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> • Njësia Administrative Mollas-Çlirim; • Bashkia Kolonjë.

Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> • Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (<i>i ndryshuar</i>); • Manualin e Menaxhmit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër Nr. 108, datë 17.11.2016 të Ministrit të Financave
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Nuk është hartuar Regjistri i Riskut për Njësinë Administrative Mollas-Çlirim, në shkëlqe të nenit 21 të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (<i>i ndryshuar</i>), parashikimeve të bëra në Manualin e Menaxhmit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër Nr. 108, datë 17.11.2016 të Ministrit të Financave, si dhe duke mos përmbushur Rekomandimet e lëna nga Raporti Përfundimtar Nr. 186/19 Prot., datë 25.07.2024 i Kontrollit të Lartë të Shtetit.</p> <p>Kriteri: Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (<i>i ndryshuar</i>); Manualin e Menaxhmit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër Nr. 108, datë 17.11.2016 të Ministrit të Financave.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Mungesa e Regjistrimit të Riskut për Njësinë Administrative Mollas-Çlirim përbën një shkëlqe të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi, duke ndikuar negativisht në menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Kjo situatë rrit ekspozimin ndaj risqeve financiare dhe operationale, ul transparencën dhe llogaridhënien në administrimin e fondeve publike dhe mund të sjellë pasoja në efektivitetin dhe efikasitetin e shërbimeve publike. Gjithashtu, moszbatimi i rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit reflekton dobësi në përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe mund të çojë në masa ndëshkuese apo kufizime buxhetore në të ardhmen.</p> <p>Shkaku: Neglizhenca në përmbushjen e detyrave funksionale.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i lartë.
Konkluzioni	Mos hartimi i Regjistrimit të Riskut përbën një mangësi serioze në sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm të Njësisë Administrative, duke shkelur ligjin dhe udhëzimet përkatëse. Për të adresuar këtë problem, është e domosdoshme marrja e masave të menjëhershme për përgatitjen dhe implementimin e këtij regjistri, si dhe për zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Përmirësimi i procesit të menaxhimit të riskut do të ndihmojë në rritjen e transparencës, forcimin e kontrollit të brendshëm dhe përmirësimin e performancës financiare të njësisë administrative.
Rekomandimi	Të merren masa për hartimin e Regjistrimit të Riskut dhe rishikimin e tij 2 (dy) herë në vit.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Çdo 6 muaj brenda vitit 2025.
Statusi i rekomandimit	Është pranuar, nuk është paraqitur Observacion.

58. **Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:** Mungesa e Regjistrit të Riskut për Njësinë Administrative Barmash-Novoselë është një shkelje e ligjit dhe normave të përcaktuara, që mund të rrisë rrezikun e mosmenaxhimit të duhur të riskeve financiare dhe operacionale. Kjo gjithashtu ndikon negativisht në mundësinë për identifikimin dhe trajtimin e riskeve që mund të paraqiten në të ardhmen. Puna e kryer në Njësinë Administrative, bazuar në projekt-raportin e auditimit, tregon se detyrat janë realizuar në përputhje me parashikimet ligjore dhe rregullat e përcaktuara. Administrata ka zbatuar procedurat e nevojshme për menaxhimin e kërkesave dhe aktiviteteve të përditshme, duke siguruar që veprimet dhe vendimet e marra janë në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe aktet nënligjore të lidhura.

59. V. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA MË PARË

Nga auditimi i kryer në vitin 2019 (auditimi i fundit) në Njësitë Administrative, është mbuluar me auditim periudha Qershor 2019-Nëntor 2019 dhe sistemet dhe fushat e audituara kanë përfshirë vetëm Sektorin e Mirëqënies Sociale pranë Njësive Administrative. Nga dokumentacioni i dorëzuar nuk rezulton të jetë hartuar apo miratuar Plani i Veprimit për ndjekjen e këtyre rekomandimeve. Më konkretisht verifikimi i statusit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm është si vijon:

Rekomandim Nr. 1

Nga ana e Bashkisë Kolonjë të merren masat për plotësimin e zyrave të ndihmës ekonomike pranë çdo njësie administrative me 1 kopje të vendimit final të përfituesve dhe jopërfituesve të ndihmës ekonomike.

Statusi: Nuk ka informacion dhe as dokumentacion mbi statusin e rekomandimit.

Rekomandim Nr. 2

Nga ana e Bashkisë Kolonjë të merren masat për njoftimin e kërkuesve për përfitimin e ndihmës ekonomike, e kërkuesve për refuzimin e ndihmës ekonomike me argumentat përkatës, nëpërmjet afishimit të vendimit dhe listave përkatëse pranë çdo njësie administrative, sipas Udhëzimit Nr.3, datë 17.02.2017, pika 16/1.

Statusi: Nuk ka informacion dhe as dokumentacion mbi statusin e rekomandimit.

Rekomandim Nr. 3

Nga ana e administratorit shoqëror në bashkëpunim me personelin e njësisë administrative apo të Bashkisë, të merren masat për krijimin e grupit të verifikimit të familjeve pretenduese për përfitimin e ndihmës ekonomike për kryerjen e verifikimeve social-ekonomike, si dhe hedhjen e të dhënave (sipas verifikimit) në regjistrin elektronik kombëtar, sipas Ligjit nr.9355, datë 10.03.2005 (i ndryshuar), neni 31, gërma "b", sipas VKM Nr. 955, datë 07.12.2026 (të ndryshuar), Kreu II, pika 2 dhe sipas Udhëzimit Nr.3, datë 17.02.2017, (të ndryshuar) pika 10.

Statusi: Nuk ka informacion dhe as dokumentacion mbi statusin e rekomandimit.

Rekomandim Nr. 4

Nga ana e Administratorëve Shoqërorë, Administratorëve të Njësive Administrative dhe Kryetarit të Bashkisë të merren masa për zbatimin me korrektësi të procedurës të ankimimit të kërkuesve për ndihmë ekonomike, sipas Ligjit Nr.9355, datë 10.03.2005 (i ndryshuar), neni 41/1.

Statusi: Nuk ka informacion dhe as dokumentacion mbi statusin e rekomandimit.

Rekomandim Nr. 5

Nga ana e Administratorëve Shoqërorë të merren masat për plotësimin e dosjeve të përfituesve me status verbëri dhe para dhe tetraplegji, në lidhje me kompensimin e faturës të energjisë elektrike dhe telefonike, me deklaratën vjetore personele të kërkuesve si dhe kopje të librezës së pagesave të faturës së energjisë elektrike, sipas VKM Nr.8, datë 14.01.2015, me VKM nr.404, datë 20.06.2012.

Statusi: Nuk ka informacion dhe as dokumentacion mbi statusin e rekomandimit.

Rekomandim Nr. 6

Nga ana e Drejtorisë së Financës të merren masat për kryerjen e rakordimit mujor me Postën Shqiptare për evidentimin dhe dokumentimin e rasteve për fituesit e ndihmës ekonomike, të cilët nuk tërheqin masën e ndihmës brenda 10 ditëve pune nga data e fillimit të pagesës nga Posta Shqiptare. Gjithahstu të merren masat që të lajmërohen administratorët shoqërorë për aplikuesit e ndihmës ekonomike, të cilët nuk kanë kryer tërheqjen e masës së përfitimit brenda 10 ditëve të punës.

Statusi: Nuk ka informacion dhe as dokumentacion mbi statusin e rekomandimit.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna rezulton se:

Në auditimin e mëparshëm, sikurse del nga Raporti Përfundimtar Nr.2091 Prot., datë 24.06.2019, janë lënë për zbatim 6 rekomandime, të pranuar nga Njësitë Administrative, megjithatë nga dokumentacioni i dorëzuar nuk del të jetë hartuar Plani i Veprimit për këto rekomandime dhe as të jenë marrë masa për të nërmarrë veprime korrigjuese.

60. **Opinion i përgjithshëm:** Veprimet korrigjuese ndaj gjetjeve të auditimit të mëparshëm nuk rezultojnë të jenë ndërmarrë , gjë kjo që nga gjetjet e konstatura në auditimin e kryer në 2024 , ka sjellë një ulje të ndjeshme dhe përkeqësim në ushtrimin e disa detyrave dhe funksionimin e disa sistemeve. Vlerësojmë se duhet ende punë vijuese që Njësitë Administrative të funksionojnë sipas kriterëve dhe kërkesave ligjore.

Raporti Përfundimtar i Auditimit hartohet në 7 (shtatë) kopje.

Grupi i Auditimit

Laura Skënderas



Arnold Fetallari



PËRMBLEDHËSE E REKOMANDIMEVE

Nr.	REKOMANDIMI	NIVELI I RISKUT
1.	Të plotësohet dosja me Vërtetim Njësimit me Originalin të Diplomës së Nivelit të dytë të Studimeve, Master Profesional në Marketing, për Administratorin e Njesisë Administrative Barmash-Novoselë.	Risk i mesëm
2.	Të merren masat për kryerjen e vlerësimit të punës sipas parashikimeve ligjore, për Administratorin e Njesisë Administrative Barmash-Novoselë.	Risk i mesëm
3.	Të rishikohet Rregullorja e Brendshme dhe të përcaktohen qartë detyrat dhe kompetencat e Njësive Administrative dhe Administratorëve si dhe linjat e raportimit .	Risk i lartë
4.	Të merren masat për t'u zhvilluar trajnime në fushën e legjislacionit administrativ, për Administratorin e Njesisë Administrative Barmash-Novoselë.	Risk i mesëm
5.	Të merren masat për emërimin e një administratori tjetër në vakancën e krijuar në Njësinë Administrative Barmash-Novoselë.	Risk i lartë
6.	Të ngrihet komision për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve publike të Njesisë Administrative Barmash-Novoselë, në zbatim të paragrafëve 107, 108 dhe 109 të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” (i ndryshuar) i Ministrisë së Financave për Njësinë Administrative Barmash-Novoselë.	Risk i lartë
7.	Të merren masa për mbajtje të rregullt të dokumentacionit për të pasqyruar drejt rastet e bashkëpunimit mes njësive me njëra-tjetrën dhe Bashkinë, nga Njësia Administrative Barmash-Novoselë.	Risk i lartë
8.	Të merren masa që në momentin e azhurnimit të infrastrukturës për dixhitalizimin e shërbimeve në Bashki, të merren në konsideratë edhe nevojat e Njesisë Administrative Barmash-Novoselë.	Risk i mesëm
9.	Të merren masa për plotësimin e detyrave ligjore dhe dokumentimin e punës së kryer në bazë dhe në zbatim të ligjit nga Njësia Administrative Barmash-Novoselë.	Risk i lartë
10.	Të mbahet Regjistri i Korespondencës (Protokollit) në përputhje me kërkesat e nenit 11 të VKM Nr. 4 datë 19.06.2017 për miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë” nga Njësia Administrative Barmash-Novoselë.	Risk i lartë
11.	Të merren masa për zbatimin e Manualit të Trajnimit Për Punonjësit e Zyrës së Arkivit dhe Protokollit të Njësive të Qeverisjes Vendore për të respektuar kërkesat ligjore mbi formatin e shkresave zyrtare, nga Njësia Administrative Barmash-Novoselë.	Risk i lartë
12.	Në gjykimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm ky fakt përbën shkelje të detyrimit të kujdesit në punë sipas nenit 24 të Kodit të Punës, për këtë arsye kërkojmë nga ana e Titullarit, si eprori direkt, të marrë masë	Risk i lartë

	disiplinore “Vërejtje me shkrim”.	
13.	Të vlerësohet autenticiteti i dokumentit Shkresë Përcjellëse Nr.5645/1Prot., datë 10.12.2024 të nxjerrë nga Njësia Administrative vBarmash-Novoselë dhe të merren masa për të konstatuar pavlefshmërinë e aktit duke qënë se i mungon një element thelbësor formal	Risk i lartë
14.	Të merren masa për vënien në dispozicion të NJAB-së kopje të njëhsuara me origjinalin të kontratave të qirasë së fermerëve për aplikimet në subvencione për Njësine Administrative Barmash-Novoselë.	Risk i lartë
15.	Të merren masa për të plotësuar dokumentacionin për Njësine Administrative Barmash-Novoselë me evidencat për kontrollin mbi detyrimet e prapambetura për pajisjen me vërtetime të qytetarëve.	Risk i lartë
16.	Të merren masa për të vendosur në dispozicion të NJAB-së nga Njësia Administrative Barmash-Novoselë, aktet që mungojnë	Risk i lartë
17.	Të merren masa për raportim periodik çdo 6 muaj mbi veprimtarinë e Njesisë Administrative Barmash-Novoselë	Risk i mesëm
18.	Të merren masa për adresimin e problematikave dhe boshllëqeve të hasura si dhe të mbahet dokumentacion shoqërues për Njësine Administrative Barmash-Novoselë	Risk i mesëm
19.	Të mbahet dokumentacioni i rregullt dhe të pasqyrojë kërkesat e qytetarëve dhe kryeqleve për Njësine Administrative Barmash-Novoselë	Risk i mesëm
20.	Të merren masa për dokumentimin e kërkesave të banorëve për nxjerrjen e vërtetimeve për Njësine Administrative Barmash-Novoselë	Risk i mesëm
21.	Të merren masa për hartimin e Regjistrit të Riskut dhe rishikimin e tij 2 (dy) herë në vit për Njësine Administrative Barmash-Novoselë	Risk i lartë
22.	Të plotësohet dosja me jetëshkrimin dhe Kontratën e Punës për Administratorin e Njesisë Administrative Qendër-Leskovik dhe të merren masat për vlerësimin e punë së kryer prej tij.	Risk i mesëm
23.	Të plotësohet dosja e personelit për punonjësen Znj. Xheni Pina të Njesisë Administrative Qendër-Leskovik me dëshminë e njohjes së gjuhës së huaj anglisht, me dokumentacionin shoqërues të procedurës së pranimit në shërbimin civil si dhe të merren masat për kryerjen e vlerësimit të punës sipas parashikimeve ligjore	Risk i mesëm
24.	Të plotësohet dosja e personelit me dokumentacionin përkatës për emërimin në detyrë të Znj. Gerida Nure, të Njesisë Administrative Qendër-Leskovik ,me dëshminë e njohjes së gjuhës së huaj anglisht, me vërtetimin përkatës të përfundimit të vitit të parë të studimeve në Master i Shkencave në “Drejtim dhe menaxhim i mediave”.	Risk i mesëm
25.	Të merren masat për kryerjen e vlerësimit të punës së punonjësës Znj. Leonora Kalavace të Njesisë Administrative Qendër-Leskovik, sipas parashikimeve ligjore.	Risk i mesëm
26.	Të ngrihet komision për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve publike të	Risk i lartë

	Njësia Administrative Qendër-Leskovik, në zbatim të paragrafëve 107, 108 dhe 109 të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” (i ndryshuar) i Risk i Ministrisë së Financave për Njësinë Administrative Qendër-Leskovik	
27.	Të merren masa që në momentin e azhurnimit të infrastrukturës për dixhitalizimin e shërbimeve në Bashki, të merren në konsideratë edhe nevojat e Njësia Administrative Qendër-Leskovik	Risk i mesëm
28.	Të merren masa për plotësimin e detyrave ligjore dhe dokumentimin e punës së kryer në bazë dhe në zbatim të ligjit nga Njësia Administrative Qendër-Leskovik	Risk i lartë
29.	Të merren masa për zbatimin e Manualit të Trajnimit Për Punonjësit e Zyrës së Arkivit dhe Protokollit të Njësive të Qeverisjes Vendore për të respektuar kërkesat ligjore mbi formatin e shkresave zyrtare për Njësia Administrative Qendër-Leskovik	Risk i mesëm
30.	Të saktësohet data e aktit nga ana e Njësia Administrative Qendër-Leskovik sipas tabelës me aktet e parregullta	Risk i lartë
31.	Të vihen në dispozicion të NJAB-së aktet e padorëzuara nga ana e Njësia Administrative Qendër-Leskovik	Risk i lartë
32.	Të mbahet saktë numri i protokollit duke filluar nga dita e parë e punës për vitin korrent, duke filluar me numër protokollit 01 dhe jo vazhdim numerik i vitit paraardhës nga ana e Njësia Administrative Qendër-Leskovik	Risk i lartë
33.	Të merren masa për mbajtjen e dokumentacionit dhe hartimin e tij në formën e kërkuar nga ligji nga ana e Njësia Administrative Qendër-Leskovik	Risk i lartë
34.	Të merren masa për raportim periodik çdo 6 muaj mbi veprimtarinë e Njësia Administrative Qendër-Leskovik	Risk i mesëm
35.	Të merren masa për adresimin e problematikave dhe boshllëqeve të hasura si dhe të mbahet dokumentacion shoqëruar nga ana e Njësia Administrative Qendër-Leskovik	Risk i mesëm
36.	Të mbahet dokumentacioni i rregullt dhe të pasqyrojë kërkesat e qytetarëve dhe kryepleqve nga ana e Njësia Administrative Qendër-Leskovik	Risk i mesëm
37.	Të merren masa për dorëzimin e dokumentacionit të munguar nga ana e Njësia Administrative Qendër-Leskovik	Risk i lartë
38.	Të merren masa për hartimin e Regjistrit të Riskut dhe rishikimin e tij 2 (dy) herë në vit nga ana e Njësia Administrative Qendër-Leskovik	Risk i lartë
39.	Të plotësohet dosja me Certifikatën Personale për Administratorin e Njësia Administrative Qendër-Ersekë, me jetëshkrimin dhe me Kontratën Individuale	Risk i mesëm
40.	Të merren masat për plotësimin e dosjes së personelit me dokumentacionin përkatës për emërimin në detyrë të Znj. Fjoralda Iljazi të Njësia Administrative Qendër-Ersekë dhe jetëshkrimin.	Risk i mesëm
41.	Të ngrihet komision për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve publike të Njësia Administrative Qendër-Ersekë, në zbatim të paragrafëve 107,	Risk i lartë

	108 dhe 109 të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” (i ndryshuar) i Ministrisë së Financave nga Njësia Administrative Qendër-Ersekë	
42.	Të plotësohet dosja me Kërkesën për pezullimin e Statusit të Nëpunësit dhe Kontratën Individuale për Administratorin Z. Xhentil Avdyli të Njesisë Administrative Mollas-Çlirim dhe të merren masat për kryerjen e vlerësimit të punës sipas parashikimeve ligjore.	Risk i mesëm
43.	Të merren masat për plotësimin e dosjes së personelit me dokumentacionin përkatës për emërimin në detyrë të Znj. Eliona Dalipi të Njesisë Administrative Mollas-Çlirim dhe të merren masat për dorëzimin e Jetëshkrimit sipas standardit Europass	Risk i mesëm
44.	Të ngrihet komision për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve publike të Njesisë Administrative Qendër-Ersekë, në zbatim të paragrafëve 107, 108 dhe 109 të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” (i ndryshuar) i Ministrisë së Financave për Njësine Administrative Mollas-Çlirim	Risk i lartë
45.	Të merren masa që në momentin e azhurnimit të infrastrukturës për dixhitalizimin e shërbimeve në Bashki, të merren në konsideratë edhe nevojat e Njesisë Administrative Mollas-Çlirim	Risk i mesëm
46.	Të merren masa për zbatimin e Manualit të Trajnimit Për Punonjësit e Zyrës së Arkivit dhe Protokollit të Njësive të Qeverisjes Vendore për të respektuar kërkesat ligjore mbi formatin e shkresave zyrtare nga ana e Njesisë Administrative Mollas-Çlirim	Risk i lartë
47.	Të merren masa për hartimin e rregullt të Proces-Verbaleve nga ana e Njesisë Administrative Mollas-Çlirim	Risk i lartë
48.	Të merren masa për raportim periodik çdo 6 muaj mbi veprimtarinë e Njesisë Administrative Mollas-Çlirim	Risk i mesëm
49.	Të merren masa për hartimin e Regjistrit të Riskut dhe rishikimin e tij 2 (dy) herë në vit nga ana e Njesisë Administrative Mollas-Çlirim	Risk i lartë

Grupi i Auditimit

Laura Skënderas

Arnold Fetallari

Observacioni i Gjetjes Nr. 4	Trajnime për stafin nuk ka pasur nga ana e Administratorit sepse nuk ka pasur staf në varësi.
Konkluzion përfundimtar i auditueve për gjetjen	Nga përshkrimi i Gjetjes Nr. 4, sikurse del nga Projekt-Raporti, audituesit i janë referuar trajnimeve të kryera nga ana e punonjësit të Njesisë (Administratorit), si punonjësi i vetëm dhe në asnjë moment nuk i janë referuar trajnimeve të stafit në varësi.
Rishikimi i statusit të gjetjes	Mungesa e trajnimeve në fushën e lejlacionit administrativ ka sjellë problematika në menaxhimin dhe kryerjen e detyrave dhe funksioneve, sikurse pranohet edhe nga Observacioni Nr. 20 i paraqitur nga ish-Administratori.
Rishikimi i nivelit të riskut	Risk i mesëm.
Observacioni i Gjetjes Nr. 5	Nuk është kompetencë e Administratorit.
Konkluzion përfundimtar i auditueve për gjetjen	Në Gjetjen Nr. 5 në Projekt-Raportin e auditimit është analizuar situata faktike e Njesisë Administrative Barmash-Novoselë në krijimin e vakancës në pozicionin e Administratorit dhe jo detyrat, funksionet apo roli direkt i ish-Administratorit në krijimin e kësaj vakance. Rekomandimi për zbatim është lënë për personin juridik (Njesisë Administrative Barmash-Novoselë).
Rishikimi i statusit të gjetjes	Nevoja për plotësimin e pozicionit vakant të Administratorit është ende prezente.
Rishikimi i nivelit të riskut	Risk i lartë.
Observacioni i Gjetjes Nr. 6	Për aktivitetet që janë në përgjegjësinë time, pritet të ngrihet në vazhdim një komision për dorëzimin e tyre dhe nxjerrjen jashtë përdorimit aktivet e papërdorshme.
Konkluzion përfundimtar i auditueve për gjetjen	Observacioni i paraqitur tregon pranimin e Gjetjes Nr. 6 të Projekt-Raportit të Auditimit.
Rishikimi i statusit të gjetjes	Nuk është ngritur ende një Komision për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të konstatuara si të tilla nga Komisioni i Inventarizimit.
Rishikimi i nivelit të riskut	Risk i lartë.

Për Njesisë Administrative Mollas-Çlirim, Qendër-Leskovik dhe Qendër-Ersekë, nuk u parqitën Observacione dhe të gjitha gjetjet e Grupit të Auditimit u pranuan.

Grupi i Auditimit

Laura Skënderas

Arnold Fetallari